

BIBLIOTEKA

E

854-32
B 92

SHTETLI

GJIROKASTER

maska de gera

NONDA BULKË

891.983 - 32



N.B.
Nelton

894-32
B 92

NONDA BULKA

MASKA TÉ CJERRA

H22.

BRITISH LIBRARY
SHELF MARK

~~35428~~

P A R A T H È N I E

Në fillim të viteve 30, u duk në letërsinë shqipe një autor i ri, me një penë të stërholluar e me një pseudonim pakëz të çuditshëm për lexuesit: *Chri-Chri*, pseudonim që ka edhe ai kuptimin e vet, ndoshta shkurtimi i largët i emrit të ndonjë flokë-verdhe që dikur do t'ia ketë prekur zemrën shkrimtarit. Ky ishte Nonda Bulka, i cili, n'atë kohë, hyri në letërsinë tonë si shkrimtar i formuar realist, si luttëtar kundër padrejtësisë shoqërore dhe si demaskues i pamëshirshëm i sistemit feudoborgjez. Penën e tij të fortë prej artisti e drejtoi dashuria për popullin, për Shqipërinë, e drejtoi dhimbja e tij për gjëndjen e mjeruar të popullit dhe dëshira e singertë për ta nxjerrë atë nga obskuran-tizmi, varfëria dhe errësira. Ishim pikërisht këto arsyë që i detyruan neveritarët e atëhershëm të hakmerreshin kundër shkrimtarit të ri, duke e internuar më 1936, ashtu siç inter-nonin, burgosnin, vrisnin, persekutonin dhe flaknin në rrugë të madhe puntorët revolucionarë, intelektualët përparimtarë dhe patriotët e vërtetë.

Nonda Bulka nuk është nga ata shkrimtarë që krijojnë vepra voluminoze. Tregimi më i gjatë i tij, që s'i kalon të njëzet faqet, është «Përçartje të një nate dimri», botuar vitet e fundit te revista «Nëndori». Krijimet e tij përbëhen nga një, nga dy e rallë e tek nga më shumë faqe. Kjo u vu re që në librin e parë të tij «Kur qan e qesh bilbili», botuar më 1934. Të tillë ishin edhe shkrimet e vëllimit «Kur qante e qeshte bilbili», botuar më 1962. Kështu janë edhe shkrimet që përmban ky libër me tregime e skica në miniaturre, të cilat autori i ka shkruar e botuar, si edhe të parat, në shtypin e viteve 30.

E përmënda këtë fakt në fillim të parathënies për të theksuar të vërtetën e njojur, se arti nuk matet me sasinë e faqeve, se vlera e vërtetë e një vepre letrare qëndron në cilësinë e saj, domethënë në përbajtjen e thellë ideore-dhe në formën e përkryer artistike.

Tregimet, portretet, etydet, skicat e këtij libri, Nonda Bulka i shkroi në një kohë kur, siç thotë edhe vetë, njeriu që viente më pak se një gjysëm leku, habitej në atë burg të hutuar që quhej jetë dhe kur bota, ky pallat madhështor, ishte kredhur në helm e vrer, në kriza ekonomike, shqërrorre e politike. Megjithëse në një nga tregimet e asaj kohe autor i shpreh mendimin se e vërteta është diku, po atë diku s'e gjejmë dot, sepse nuk e çquajmë dot ngjyrën e së vërtetës, ai, me syrin e tij të vëmëndshëm prej shkrimitari, e gjeti të vërtetës e jetës shqiptare, e kuptoi karakterin qfrytëzues e koruptues të shoqërisë feudoborgjeze, e pa mjerimin e popullit dhe e bëri fjalën e tij artistike mjet për të goditur rregullim, veset dhe plagët e asaj shoqërie, për të çjerrë maskën e saj hipokrite e demagogjike.

Nonda Bulka, si shkrimitar realist, në shkrimet e tij është nisur gjithënë ngajeta, nga realiteti, nga fenomenet e saj më të ndryshme e më të rëndomta dhe ka arritur në përgjithësimë artistike, duke pasqyruar me vërtetësi faktet e popullit tonë dhe gjëndjen reale të Shqipërisë në atë kohë

Në shumë skica të këtij libri, duke pëershkruar varférinë dhe mjerimin, me anën e mjeteve artistike që janë specifike vetëm për të, herë hapur, herë në rrugë të tèrtorta, ai shpreh dashurinë e zjarrtë për masat e varfëra dhe urrejtjen e madhe për klasët në fuqi, për pasanikët e qeveritarët. Në faqet e këtij libri, ashtu si edhe në dy vëllimet e mëparëshme, ai proteston dhe stigmatizon me një ironi therrëse karakterin koruptues të shoqërisë s'atëherëshme. Pena e tij i shërben kritikës kundër ministrave e deputetëve, kundër aparatit burokratik, kundër intelektualëve me kulturë të bastarduar, kundër psikologjisë e moralit të tyre të kalbur.

Tri gjëra s'i sheh dot pa t'u errësuar sytë, thotë autorin: diellin, vdekjen, realitetin. Dhe ai ka parasysh pikërisht realitetin e zymtë shqiptar të asaj kohe ku njerzit lindnin, jetonin, punonin e djersitnin vetëm për një kafshatë bukë, ku fjalët: drejtësi, lumburi, dashuri e sinqueritet ishin vetëm për të zbuluar muzetë, ku mjaftonte një shëtitje e shkurtër nëpër rrugët e Tiranës që të shihje lypsit apo malësorët, në buzët e të cilëve s'vihesht re as buzëqeshja legjendare, as krenarija e zakonëshme, që s'dinin as të shkruanin, as të këndonin, po dinin vetëm të vuanin. Ky realitet i hidhur e bën autorin të thotë me sarkazëm: Dua të buzëqesh, po mëndja më vete te thesi i miellit, që u boshatis... dua të jem optimist, po s'mund. Me atë buzë-

qeshjen e tij karakteristike, të hollë e tallëse, ai parodizon me vargjet e Omar Kajamit. S'është koha për të thënë:

Merr një zemër, puthe dhe rrëmbeje...

Është koha për të thënë:

Merr një thes misër, puthe dhe rrëmbeje!

C'tingëllim plot ironi! C'tabllo e gjallë e jetës dhe q'protestë e fortë nëpërmjet të fjalës artistike!

Kush është shkaktar për këtë gjëndje të mjeruar të popullit? — pyesim ne lexuesit së bashku me autorin. Dhe, megjithëse Nonda Bulka te shkrimi «Fajtori» thotë në fund: *Zgjidhni e merni*, edhe ai mendon, si të gjithë ne, se shkaktar dhe fajtor është rendi shoqëror i ngritur mbi padrejtësinë, injorancën dhe forcën. Dhe *Chri-Chriu*, siç u tha edhe më lart, sulet kundër këtij rendi me të gjitha bateritë e penës së tij satirike, duke qëlluar të gjitha hallkat që mbanin këtë rend, nga drejtuesit si Musa Juka me shokë, ministrat e deputetët, gjer tek zyrtarët e pashpirt dhe nepërkat e tjera, që ishin mbështjellë rreth qafës së popullit tonë. Ai tallet hapur me baballarët e kombit që vinin varavingo në parlament (zor se mund të gjendet ndonjë fjalë tjetër kaq sarkastike, si fjala *varavingo*, për të karakterizuar n'atë kohë punën e deputetëve). Ata vinin varavingo, bisedonin pa rreshtur, mbushnin xhepat e tyre, kurse buxheti vuante prej hemoragjisë. Penës së tij e syrit të tij nuk i shpëtonin as oratorët llafazanë e gënjeshtarë, që mbanin llogo duke përdorur në çdo fjalim vetëm dhjetë fjalë të thata, as fajdexhimjtë, tregtarët e tagrambledhësit gjakpirës, as intelektualët hipokritë e intrigantë, as njerzit e penës, që shkruanin me këmbë, as librat fetare e perëndija, që s'janë gjë tjetër veçse përralla për t'u zbavitur në netët e gjata të dimrit, as hoxha e prifti, që hyjnë si majdanos në çdo gjellë dhe as ata mëndjelehtë e megalomanë, që përpinqeshin të mohonin traditat e bukura letrare.

Në librin «*Maska të çjerra*», ka shumë skica e fejtone që bëjnë fjalë mbi gjëndjen politike, ekonomike e shoqërore të botës. Edhe këtu autori niset nga pozitat përparimitare antiimperialiste e antifashiste të kohës. Është gjithnjë realist, i mprehtë dhe i thellë. Pena e tij satirike shfren me urrejtje kundër vëndeve imperialiste, kundër luftrave të padrejta e grabitqare, kundër traktateve politike e aleanca-

ve ushtarake, që u shkojnë ndesh interesave të popujve, kundër fashizmit, që ishte ahore në lulëzim e sipër. Në këto shkrime që janë një pasqyrë e qartë e gjëndjes ndërkombëtare në botën kapitaliste, kemi një shëmbull të bukur se si mund të kombinohet pena e shkrimtarit me penën e gazetatit. Nonda Bulka interesohet si një kronist i rregullt, jo i thjeshtë, por si artist, për të gjitha çështjet më të rëndësishme politike dhe i trajton ato aq drejt, sa shumë nga shkrimet të duket sikur janë shkruar sot e jo tridhjetë vjet më parë. Autori ve re me dhimbje se në botën e kapitalit ku kanë shpërthyer krizat, tridhjet e kusur milionë njerëz ngrysen e gdihen pa bukë, fytyrat u janë fishkur prej urisë dhe dëshpërimit, popujt, të gënjer nga oratorët sharlatanë, ideologë të borgjezisë, s'dijnë nga t'ia mbajnë, ndërsa imperialistët majmen në kurriz të popujve dhe pregatitën luftën e re botërore. Diplomatët ven' e vinë — shkruan ai — kam frikë se do pëlcasë lufta. Duke e kuptuar se shpërthimi i një lufte të re botërore është i paevitueshëm, Chri-chriu damkos imperialistët dhe drejtuesit e shteteve të mëdhenj kapitalistë që ia kanë me të pabesë njëri tjetrit dhe që pregatisin një kasaphanë të re, pyet me ironi përsë shkaktarët e luftrave nuk i myllin nëpër çmendina, quan paçavure traktatin e Versajës, tallet me konferencat e çarmatimit e të ndihmës ekonomike duke i quajtur ato gënjeshtira, ve në lojë pacifistët dritëshkurtër, të cilët në fund të fundit s'janë gjë tjetër veç se shërbëtorë të borgjezisë së madhe, hipokritë dhe egoistë dhe arrin në konkluzionin e drejtë se s'ka paqë deri sa një popull sundohet prej tjetrit. Në luftën e parë botërore fituesit ishin Krupët dhe Shnejderët, të cilët, duke fabrikuar topa, fituan për çdo ushtar të vrarë, 250 000 franga franceze. Po këta Krupë, Shnejder e kompani pregatitën dhe shpërthyen luftën e dytë botërore duke vrarë miliona njerëz. Ja qytetërimi i bastarduar i botës kapitaliste. Nonda Bulka ia çjerrë maskën t'ashtuquajturit qytetërim evropian dhe parajsës amerikane që s'është në të vërtetë parajsë. Ai e krahason imperializmin me lanetin, i cili e ndan botën në sfera influence, e shtyp, e varfëron dhe e shpie drejt katastrofës, drejt luftës. Megjithëse diplomatët çirren për paqë dhe, sa për sy e faqe organizohen konferanca në Gjenevë, të gjitha këto, thotë autorri, s'janë gjë tjetër veçse leqe për të gënjer tevegjelët.

Në këto shkrime qëndrimi emocional i autorit është gjithnjë në anën e popujve e sidomos në anën e popujve të shtypur. Duke urryer imperializmin japonez, që shtypte

popullin kinez, ai simpatizon këtë popull të madh që ishte agritur ahere në luftë kundër okupatorit të huaj, dënon hilieriamët që organizonin pogrome kundër çifutëve dhe si patriot demaskon fashizmin italian që kish hedhur kthetrat në ekonominë tonë e preqatiste okupacionin e hapur si dhe armiqjtë e tjerë të vëndeve fqinjë që nuk ia donin të mirën Shqipërisë. Me sarkazëm ai godet enciklopedinë italiane, e cila, jo pa qëllim, e quante Shqipërinë si një krahinë turke dhe një të ashtuquajtur shkencëtar sërbomadh, cili, edhe ai jo pa qëllim, na quajti njerëz të egër e bile me bisht. Të gjitha shkrimet e këtij karakteri kanë edhe sot një rezonancë plot kuptim dhe janë aktualë, sepse pikërisht me metoda të tilla veprojnë edhe sot armiqjtë tanë.

Është interesante të theksohet këtu se Nonda Bulka, me gjithë censurën e fortë, gjeti mundësinë dhe mjetet për të thënë fjalë të drejta e të ngrohta për udhëheqësit e më-dhenj të proletariatit.

2

Megjithëse shkrimitari në krijimet e tij është nisur nga pozita përparimtare e demokratike, botëkuptimi i tij ka që-në i kufizuar nga kushtet e kohës. Duke demaskuar frymën antipopullore të regjimit zogollian, thelbin ekspluatues të klasave në fuqi, forcat reaksionare të brëndëshme e të jashtëme dhe duke dashur singerisht t'ua lehtësojë gjëndjen e rëndë masave popullore, Nonda Bulka nuk mundi të tregojë me bindje të plotë rrugën e vërtetë në të cilën duhej ecur për të arritur në fitore. Në skicën Palla e Lekës së Madh ai shprehet në mënyrë simbolike se, për të zgjidhur koklën gordhiane, domethënë për të përmbysur situatën, duhet vepruar ashtu siç veproi Leka i Madh, i cili e preu atë me shpatë. Shpatën e kemi, thotë autori, dora na mungon. Këtu, me sa duket, ai bën një aluzion të drejtë se popullit shqiptar, për të shpëtuar nga gjëndja e vështirë, i duhet një dorë e fuqishme që ta drejtojë e ta shpjerë në fitore. Por, megjithëse shkrimitari arrin në këtë konstatim të drejtë, ai nuk e pa atë forcë që do ta drejtonte e do ta çlironë popullin dhe as që mund të shkruante për të, jo vetëm sepse censura nuk do ta lejonte, por edhe sepse kjo forcë ish ahere tek ne në embrionet e saj.

Vija e kuqe që përshkon këtë libër dhe merita e parë e madhe e autorit të saj është protesta e fuqishme kundër botës së bazuar në ekspluatimin e masave, është mohimi

i gjithanëshëm i kësaj bote. Me anën e penës Nonda Bulka kritikon ashpër themelet e saj, nxjerr në pah anët më negative e më të neveritëshme dhe, megjithëse këtë luftë e bën në emër të çlirimt e të përparimit të popullit tonë, mbetet në kuadrin e shkrimtarit të realizmit kritik.

Duke përvëluar me satirën e tij çdo gjë të vjetër e reaksionare rrallë e tek edhe në këtë libër do të gjejmë ndonjë notë hidhërimi të thellë, që arrin nganjëherë gjë në pesimizëm. Kështu për shëmboll më një nga tregimet e shkruara në atë kohë «Gjurma e lotit», sipas autorit, njeriu s'është gjë tjetër, veçse një klloun qesharak për të ardhur keq, i pafuqishëm ndaj së keges, që lot në jetë një komedi dhe me të cilin tallet gjithë universi. Nota të tillë, ku më pak e ku më shumë, pëershkojnë edhe disa nga krijimet të të gjithë brezit letrar përparimtar të viteve 30. Atmosfera e kohës ishte aqë mbytëse dhe tragjike, sa i bënte intelektualët përparimtarë të bridhnin me ëndëra të përbysura. Kjo atmosferë e rëndë derdhë hidhërim në shpirtin e tyre dhe i bënte nga një herë që të binin në pesimizëm edhe shkrimtarët më optimistë. sic ishte e siç është akoma edhe sot Nonda Bulka. Dihet se pesimizmi është një kategori e parancueshme për letërsinë e vërtetë që ka si qëllim t'u shërbuje masave të popullit. Por me gjithë këtë, duke patur gjithëmonë parasysh gjëndjen tragjike në të cilën krijuan shkrimtarët tamë, unë do të mendonja se në letërsinë tonë të viteve 30, si te Nonda Bulka, ashtu edhe te të tjerët, përvec kësaj ane negative, notat pesimiste në fund të fundit përbënë edhe ato një mohim, akuzë e protestë kundër regjimit në fuqi. Po sigurisht nuk është pesimizmi karakteristika kryesore e autorit të këtij libri. Nonda Bulka është optimist, plot humor, ka besim në të ardhmen dhe të qeshurën e tij sarkastike e drejtom gjithnjë aty ku duhet. gjithnjë godet në shënje.

Për optimizmin e tij dëshmojnë veprat që ai ka botuar mbas çlirimt në fryshtë e metodës së realizmit socialist.

3.

Nonda Bulka është një shkrimtar origjinal, thellësisht shqiptar, vazhdues besnik i traditave më të mira letrare, me individualitetin e tij artistik, mjeshtër i tregimit të shkurtër, i skicës, i fejtonit dhe i publicistikës. Ai ka stilin e tij të quartë e të rrjedhshëm, ka një formë të shkruari

krejt personale që nuk mund ta ngatërrosh me asnje shkrimtar tjetër dhe qështë më me rëndësi, frazat e shkurta janë të ngjeshura me mendime të thella. Edhe aty ku pëershkruan peizazhin, megjithëse në këtë drejtim qështë shumë dorështënguar, ky peizazh s'është ndonjë qëllim në vete, as ndonjë zbulim letrar, po mjet për të shprehur më mirë mendimin e tij, për të zbuluar e shpjeguar thelbin e qështjes. Gjithnjë tek ai për sa i përket peizazhit do të gjejmë vetëm ndonjë frazë, për shëmboll si kjo: Një kohë e keqe, e vrenjtur si shpirti i fshatarit pa bukë.

Shkrimtarin nuk e intereson shumë subjekti, të cilin ai e pëershkruan me pak rreshta. Subjekti i duhet për të thënë ide të thella që të tronditin. Megjithëse në libër ka shkrime kushtuar një teme të caktuar, prapë se prapë ato nuk mund t'i ndash me thikë e t'i futësh në kallëpe të caktuara tematike mbasi, më të shumtën e herës, më një shkrim mpleksen disa tema, disa ide. Nonda Bulkës është kryesisht satirik, po nuk i mungon lirizmi i hollë që rrjedh nga shpirti i poetit si një burim i kulluar. Stili i tij është lakonik e shumë dinamik. Me një frazë thotë shumë, qdo fjalë ka kuptimin dhe rëndësinë e vet. Ai i përbuz fjalët e errëta e boshe. Gjuha dallohet nga përpikmënia e mprehtësia dhe në tërsëi është e figura shpesh, shprehëse, e ashpër ku tingëllon pa zbulurime herë realiteti i hidhur, herë dhimbja, herë ironia, humor, sarkazma. Shkrimtari nuk bën humor duke përdorur dialektet, zhargonet e fjalët arkaike, por duke përdorur një gjuhë të pastër, origjinal, me krahasime që janë në natyrën e gjuhës shqipe, me fjalë të urta të popullit, të cilat ai i çmon shumë, sepse me anë të tyre pasqyron realitetin, shpreh qëndrimin e popullit ndaj këtyre ose atyre fenomeneve jetësore dhc jep karakteristikat satirike të forcave armike. Dhe megjithëse është detyruar të përdorë shpesh të ashtuquajturën gjuhë të Ezopit, merita e madhe e tij qëndron në faktin se gjuha e tij është e qartë dhe e kuptueshme nga të gjithë.

Të gjitha shkrimet që përmban ky vëllim, si edhe shkrimet e dy vëllimeve të më parëshëm, kanë qënë botuar në shtypin e kohës. Vlera ideologjike, edukative dhe historike e një vepre letrare, me përbajtje të thellë shoqërore e politike që është krijuar sidomos në kohën e Zogut, është e madhe, në qoftë se ajo u botua dhe ra më dorën e lexuesit që në atë kohë. Të tillë ishin shkrimet e Nonda Bulkës që u botuan pothuaj në gjithë organet e shtypit me pseudonime të ndryshme: herë Na-Na, herë Sti-Sti dhe më të

shumtën e herës Chri-Chri. Dhe ato u botuan jo pse kishte ndonjë liri shtypi, jo për miopinë e censurës dhe as për dashamirësinë e kryeredaktorëve, mbasi dihet mirë që në atë kohë s'kishte liri shtypi, cenzura ishte e fortë dhe shumica e kryeredaktorëve ishin me pikpamje konservatore dhe reakcionare. Ato, u botuan, sepse Nonda Bulka për t'i shpëtuar censurës përdori me mjeshtëri e me guxim shumë mjete, mënyra e forma të ndryshme letrare si hiperbolën, metaforën, simbolin, alegorinë dhe gjer personazhin e vjehrës, i gjetur aqë bukur prej tij për t'u hedhur hi syve botonjësve të ndryshëm. (Shih p.sh. «Musa Juka»). Po sigurisht, Nonda Bulka nuk i përdori këto forma të stërholluara vetëm për të gënjer cenzurën dhe as për të dëfryer lexuesin. Ai e përdori satirën dhe humorin për të nxjerrë sa më shumë në relief anët negative të shqërësë, për të treguar në mënyrë sa më bindëse atë gjë që ish më tipike për këtë shqëri. Dhe këtij qëllimi ia arriti.

Libri «Maska të qjerra» ka vlerë të madhe njohëse edhe në ditët tona. Autori i tij, duke hyrë thellë në thelbin e jetës shoqërore e politike dhe duke e mishëruar atë në figura të gjalla artistike, na ka dhënë një ilustrim artistik të qartë e të vërtetë të Shqipërisë e të gjendjes ndërkombëtare në vitet 30. Por kjo vepër s'është një ilustrim i thjeshtë i realitetit historik të atyre viteve. Ajo ka edhe vlerë të madhe ideologjike, edukuese, sepse është një armë në luftën tonë kundër gjithë armiqve. Ajo na njeh me të kaluarën e hidhur historike dhe edukon tek ne ndjenjën e urrejtjes për atë kohë tragjike të jetës shqiptare, për regjimin zogollian, që e kish kthyer jetën në një burg të vërtetë. Ajo na bën të urrejmë botën e vjetër të kapitalit, të shfrytëzimit e të shtypjes me gjithë moralin, mënyrën e jetesës, edukatën dhe psikologjinë e saj. Në këtë vështrim vepra e Nonda Bulkës është e fortë dhe vepruese.

Në Shqipëri ka marrë fund përgjithënjë bota e vjetër që pëershkruan Nonda Bulka në këtë libër. Ajo dorë që mungonte ahore u gjend në gjirin e popullit dhe e preu me shpatë nyjen gordhiane në nëndorim e 1944. Sot, po ajo dorë, Partia e Punës, e drejton Shqipërinë në rrugën e socializmit, që është e vëtmja rrugë e drejtë dhe e sigurt e lulëzimit dhe e përparimit.

Fatmir Gjata

F A J T O R I

Ustaj i panjohur që ka ndërtuar këtë pallat madhështor, po të kredhur në helm e vrer, që quhet Botë, s'ka qenë ndonjë zanatçi i mbaruar. Ndofta s'i ka dashur qejfi. Se kontrollorë mbi veprën e tij s'kish aso kohe. Shumë të meta, shumë brenga, shumë lötë, shumë psherëtima, shumë gjak kanë dalë prej njeriut. Dhe shumë më keq e kemi në të ardhmen.

Horizonti sa vete po errësohet! Re të zeza e të trasha po mbulojnë qiellin e kaltër. Bilbili qan, në vend ë është të këndojojë. Diplomati qesh, në vend që të qajë. Dhe populli qesh e qan, se s'di ç'të bëjë.

Ç't'i qash më parë kësaj bote? Mëma i thosh Selmanit: «Bir Selman i nënës, ç'të të qaj më parë». Selmani është bota, është njerëzimi, janë veprat njërezo.

Bajroni në një minutë, kur dëshpërimi i tij kish arritur kulmin, i thotë vetes: «Qesh me veprat njërezo, se nuk mund të qaj». Dhe pesimisti poet vdiq i dëshpëruar.

Sot tridhjet e kusur milionë ngrysen e gëdhihen pa bukë, fytyrat u janë fishkur prej urisë dhe dëshpërimit. Krizë ekonomike, krizë sociale, krizë politike kudo.

Dhe kriza ekonomike pjell krizën politike. Ministra e kryeministra ngrihen e bien si marioneta. Dhe të diturit janë mbledhur në Gjenevë që të zhdu-

kin luftën. Ç'shaka e bukur! Ç'shakaxhij tragjikë! Se çdo shtet fabrikon tym e barut, po në atë kohë kur delegati i tij flet për qarmatim. Dhe popujt presin, presin me padurim shpëtimin...

Jam pesimist! Dua të jem optimist, po s'mund.

Dua të buzëqesh, po mendja më vete te thesi i miellit që u boshatis.

Dua t'ja mar këngës, po zëri m'u ngjir nga lutjet te Zoti.

Dua të hedh valle, po këpucët s'më kanë shuaj.

Dua të dehem me raki, po sëmundja i dogji vreshtat.

Dua të ble qëngj për Pashkë, po arsyen të ndryshme më ndalojnë.

E para, se s'kam lekë; (për të tjerat, s'ka nevojë).

Dua t'i lutem Zotit, po jam ngjirur.

Dua të zhdukem nga faqja e dheut, po njerëzit s'më lenë.

Një shëmbëll tragjikomik i dëshpërimit njerëzor: Një njeri ra nga dynjallëku dhe nga meraku piu helmin. Miqtë arrinë dhe e shpëtuan nga vdekja e domosdoshme. Pasi ardhi në vete, të gjithë sa e rrethonin u larguan. Ky me sy të errur kthehet e u thotë: «Mirë që s'më latë të vdes, po tani më jepni të ha»!

Fjalë plot kuptim, plot brengë, plot helm. Shqëria s'e lë njerinë të vrasë veten. Feja i mohon edhe të drejtën e varrimit. Po as njera, as tjetra, s'i japin të hajë.

Kush është shkaktar i këtyre halive? Kujt i bie përgjegjësia? Vallë atij që bëri njerinë? apo atij që na gostiti me këto dy para mend?

Po kush e bëri njerinë? Gjyshja më tha se njerinë e bëri Zoti, se kështu i kish thënë prifti. Ndofta

prifti ka tē drejtë. Po unë them se njerinë e bëri majmuni. Kështu tërë fajin le t'ja ngarkojmë majmunit.

Pas fjalëve të gjyshes, faji duhet t'i bjerë Zotit. Po unë s'dua të bëhem gjynahqar. Prandaj, sa të akuzoj Zotin, preferoj të akuzoj majmunin.

Zgjidhni e merrni.

Gazeta e Korçës 9.IV.1932

IRONI E SHEKULLIT

Çdo gjë ka ironinë e vet në këtë botë.

Po a ka gjë, i është ironike se çelja e konferencës së çarmatimit në një kohë kur atmosfera kundërmon erë tym e barut? Ka njerës që besojnë se lufta e 14-tës mori fund, se paqja u themelua me anën e Perëndisë në Jetë të Jetëve... Ironi fetare juhu!

A ka gjë, më ironike nga traktati i Versajit? Klemansò¹⁾ dha Lloid Xhorxh²⁾ i hodhën ironikisht piper të kuq presidentit Vilson³⁾. Tigri kullufiti delen.

S'është hera e parë... as edhe e fundit. Ironi e paqës!

Si Kajzeri që i deklaroi botës luftën, ashtu Briandi⁴⁾ u përpooq t'i deklarojë paqën. Përgjigja ironike e topavet japonezë e helmoi plakun naiv dhe ai vdiq me një buzëqeshje skeptike dhe ironike.

Ka njerës që hedhin në det grurët, misrin ose kafenë... që të mos u bjerë çmimi.

Ka fukarenj që ngordhin urie. I pasuri kërkon shqerra për pashkë, fukaraj kërkon punë ose bukë. Ironi shoqërore!

1) Kryeministër freng antigjerman.

2) Diplomat anglez.

3) President i Shteteve të Bashkuara.

4) Diplomat freng pacifist deri në naivitet.

Një djalosh i thotë me ironi asaj që nuk dashuron më:

— Kisha mbledhur për ty këto lule të bukura, po para fytyrës sate engjëllore dhe të njomë, këto lule më duken të veshkura. Për të mos poshtëruar lulet vendosa t'ia dhuroj një tjetre.» Ironi e hidhur e dashurisë! Ku fillon dhe ku mbaron ironia! As dreqi as i biri s'e merr vesh.

Gazeta e Korçës 7.IV.1932

422.

38128

GËNJESHTRA QË DUHEN BESUAR

Një lajm me rëndësi të veçantë fluturon prej Gjeneve. Është i vërtetë? Është i rremë? Nuk e di. Në fund do ta merrni vesh.

Konferenca e çarmatimit mori fund. Mbledhja madhështore rroddhi në një atmosferë të kthiellët. Një delegat kish ngrënë bakalaro me hudhra dhe kjo e errësoi pak atmosferën e kulluar! Thuhet se ishte delegati japones. Por s'është e sigurtë. Çarmatimi i përgjithshëm u pranua me unanimitet. Topat dhe mitralozat do të zbuluarojnë muzetë. Nëndetset do të shërbejnë për të zënë peshq ose ngjala. Aeroplani do të shërbejnë për të shpënë njerëzit në hënë. Lufta nationale u varros me pompë madhështore. Kishin marrë pjesë në ceremoni priftërinjt e hoxhallarët e tërë botës.

Ushtria kombëtare u zhduk! Ushtria ndërkombëtare u formua.¹⁾ Veshja e ushtarit ndërkombëtar do të jetë kjo: kapele francezi, kapotë anglezi, pantallona italiani, bajonetë japonezi, pushkë amerikani, fishekllëke austrie dhe kopsa hungarezi.

Ushqimi ndërkombëtar do të jetë më i çuditshëm: makarona italiane, piper të kuq bullgar, derra të butë ose të egër sérbe, verë franceze, konjak greku,

1) Shumë diplomatë e kishin me gjithë mend formimin e një ushtrie të tillë ndërkombëtare.

qumësht zvicre, konserva shqiptare (prej liqenit të Maliqit), birrë gjermane, pilaf turqie dhe çervish afganistani. Akciu është amerikan. Japonia ndes zjarrin. Anglezi hedh vajguri, kur zjarri s'don të ndizet.

Ushtari ndërkombetar do të ketë edhe fenë ndërkombebare. Në një tempull ndërkombetar do të jenë njera pranë tjetrës ftyra e Muhametit, e Krishtit, e Moisiut, e Judhës, dhe e shejtanit (se ka njerës që i besojnë).

Të ecurit e ushtarit ndërkombetar do të jetë ndërkombetar. Por s'është gjë e kollajshme. Gjermani dhe anglezi, kudo që venë, në luftë ose në dasmë, ecin me hap ushtari.

Francezi dhe italiani ecin si latinë, d.m.th. pa rregull. Spanjollit i mjafton një hap për të ardhur nga Primo de Rivera¹⁾ gjer te Alkala Zamora. Amerikani ecën mbi tokë, por sytë i ka në qzell. Japonezi s'bën hap pa vrarë njeri. Si mund të rregullohet të ecurit ndërkombetar? S'e di.

Por ajo që ka rëndësi të madhe është të qeshurit ndërkombetar. Anglezi, gjermani, amerikani, kur qeshin duken sikur qajnë. Francezi, Italiani dhe spanjollit, kur qajnë, duken sikur qeshin. Japonezi s'di as të qeshë as të qajë; di vetëm të bombardojë dhe të bëjë «harakiri» (vetëvrasje).

Anglosaksonët qeshin me gjëra që latinëve s'u bëjnë përshtypje. Latinët qeshin me gjëra që anglosaksonët vrenjen. Shëmbell: Një fshatar vjen në pazar për të blerë misër. Hipur në gomar shkon përmes pazarit; samari kthehet, fshatari rrëzohet prej gomarit dhe shëmbet. Francezi me italianin, me një pamje të tillë, çkulen së qeshuri; anglezi dhe amerikani vrenjen dhe kërkojnë shkakun e rënies së fshatarit. Dy

1) Kryetarë të shtetit spanjoll që rrëzonin njeri tjetrin.

raca, dy psikologji. Të qeshurit ndërkombe tar ka rëndësi politike të madhe. Mosmarrëveshja çqetson diplomatët. Është frikë për...

Kalamajt e ushtarëve ndërkombe tarë duhet të kenë formë fizike ndërkombe tare. Sy japonezi, vetulla italiani, hundë francezi, zverk anglezi, kokë bulgari, buzë senegaleze, trup polonezi dhe mustaqe spanjolle, (më falni se u gabova, foshnja kur lind s'ka mustaqe). Gjuha është esperanto.

Dhe kështu u sigurua paqja një herë e mirë.

Ç'kërkoni tashti? Misér? Do ta gjejmë dhe atë. Pse s'vini ushtarë ndërkombe tarë?

Këtë génjeshtër ua kisha borxh për ditën një prill. Se atë ditë njeri s'më besonte. Sot mund të më besojnë.

Gazeta e Korçës, 28.IV.1932

FJALË PËR TË ZBUKURUAR MUZETË

Napoloni thotë se fjala «impossible» (e pamundur) duhet hequr nga fjalori i çdo kombi; se s'kish gjë për Napoleonin që t'ish e pamundur; por tërë bota s'janë Napoleonë; pastaj pse e tha Napoleoni nuk do të thotë se është doemos e vërtetë. Napoleoni ish njeri, dhe si i tillë mund të gabohej. Se ka gjëra të «pamundura» në botë; për shëmbëll: është «e pamundur» të jesh kandidat pér deputet dhe të mos bësh pak a shumë demagogji. Është «e pamundur» të piqesh me tagrambledhësin dhe mos të të kërkojë para. Është «e pamundur» të mos mërzitesh duke kënduar një fjalim të gjatë në kreshmën e madhe, qoftë edhe sikur të jetë oratori një nga më të mirët në botë. Është «e pamundur» të jesh tregëtar e të mos gënjesht; të jesh student e të mos kesh bastun është «e pamundur»¹⁾.

Ja që paska gjëra «të pamundura» në botë.
Po fjala «lumturi» e meriton vallë të jetë në fjalor?

Ku është lumturia? Ku është futur? Në shpatullat e errëta të dheut? Në hapësirat e pafundme të qie llit? Në parajsë vallë? Po atëherë ç'na duhet? «Vuaj në këtë botë që të fitosh tjetrën», thotë shenjtori. Dhe unë përgjigjemi: «më mirë një ve sot se sa një pulë

1) Mjaft studenta mbanin bastun për snobismë.

mot». Se muhabeti i parajsës është si ai malli që shet veresie; s'je i sigurtë në do t'i marish apo jo paratë.

Drejtësi. Ç'fjalë njerëzore? E kthiellët, plot kuptim, që tingëllon si rrufe në vesh. Kush nuk e ka në majë të buzës fjalën drejtësi? Tre gjigandët e historisë, Sokrati, Krishti dhe Muhameti s'e hiqnin nga goja. Priftërinjtë e mesjetës përvëlonin në flakë «me emër të Zotit e të drejtësisë» çdo njeri që s'mendonte si ata. Napoleoni, në emër të drejtësisë shpuri në kasaphanë gjysmë milion djelmosha që s'ishin çmallur mirë me mëmat e tyre. Kaizeri e Co., në emër të drejtësisë i vunë zjarrin botës dhe skuqën fushat e lulëzuara me gjak ushtarësh që s'ditën pse u vranë. Ky është kuptimi i fjalës drejtësi. Në guxoni futeni në fjalor; po të më pyesni mua, do të thosha: jo! Lumturia dhe drejtësia kanë pasur dikur vleftë, qytetërimi perëndimor ua hoqi kuptimin; dhe fjalët e bukura u vjetruan. Shërbejnë vetëm për të zbukuruar muzetë. Nukë?...

Gazeta e Korçës, 25.V.1932

DIPLOMATËT VEN' E VINË

Diplomatët e shteteve të mëdha, kur e shohin punën pisk, bëjnë udhëtime... ose mbajnë fjalime; pse jo? As fjalimi, as udhëtimi s'kushtojnë gjë. Një kroko me ve e qumëshët mjafton pér të bërë një fjalim të tingëllueshëm. Udhëtimet paguhet prej të tjerëvet. Udhëtimet diplomatike s'janë nonjë çpikje e re.

Më 1914, kur zjarri që do të përvëlonte më vonë botën ish akoma shkëndijë, Poinkarea¹⁾ udhëton në Rusi «me letrën e mbretit të Angliterës në xhep»; kur u kthyte diplomatë plak, shkëndija u bë flakë dhe skuqi fushën e gjelbëruar. Kaizeri gjeti rast pér të bërë «yrysh»; por të shkuara të harruara. Në ditët tona udhëtimet diplomatike vazhdojnë.

1931 — 1932 — '33.

Hoveri fton Lavalin pér regullimin e borxheve dhe stabilizimin e paqës: Lavalit²⁾ niset e vete.... dhe vjen siç vajti. As borxhet u rregullan, as paqja u stabilizua. Grandit³⁾, pas Lavallit, viziton botën e re; u kthyte xhepat plot me premtimes «Yankes».

Më vonë Briandi me Lavalin vanë në Berlin. Armiqësia franko-gjermane duhej të merrte fund.

1) Diplomat frëng

2) Kryeministër i Francës.

3) Ministër i punëve të jashtme të Italisë

Por atje ku shpresonin të piqeshin me hien pak a shumë pacifike të Stresmanit, takuan siluetën luftetare të Hitlerit. Briandi buzëqesh me ironi. Laval var buzët me inat. Dhe mbasi hëngrën drekë dhe dëgjuan fjalime të zjarrrta rrëth miqësisë të të dy shteteve, u kthyen, duke shtuar në aktivin e politikës frëngje një «zero me xhufkë».

Dhe Bruningu¹⁾ vjen në Paris. Kërkon borxh që të paguajë borxhet, vete në kishë, falet si katolik i mbaruar që është; mban fjalime, dëgjon fjalime... dhe kthehet i entuziasmuar nga premtimet. Rezultati: një vërë në ujë për hesap të aktivit gjerman. Se premtimet janë si ato «bekimet apostolike» që Papa i dërgoi dikur Kastriotit.

Venizellua është dhe ai diplomat; përsë të mos bëjë dhe ky si shokët udhëtime? Niset «dinaku gjiritlli» siç thonë francezët, troket portë më portë, qan hallet me urtësi, kërkon borxh..., s'i jep njeri, dhe kthehet; por grekët kanë një mënyrë të veçantë që të çmojnë njerëzit e mëdhenj: i zënë me shpella. Dhe Venizellua bie më hundë. Në ka një perëndi, vetëm ajo e di. Dhe udhëtimet po vazhdojnë.

Kam frikë se mos ndonjëherë, udhëtimi diplomatik i shëmbëllen atij të Poinkaresë që bëri më '14. Atëhere djalli që na mori; se, siç thotë populli: «do të lozë qeni i kallanxhiut».

Gazeta e Korçës, 4-VI-1932

1) Kancelari i Austrisë që më von u vra prej Hitlerit.

PALLA E LEKËS SË MADH

Lufta e katërbëdhjetës nxiroi më '18, dhe u varros me ceremoni më '19; por vdiq e gëzuar se la një trashëgimtar, një djalë si pëllumb; djali u pagëzua; kumbaret ishin Klemanso dhe Lloid Xhorxhi. Dhe emrin ja vunë «Traktat i Versajit». Sot djali është sëmurë; vuan prej kancerit; ka trashëguar sëmundjen e nënës së vet, se baba i tij, që e thonë Kaizer, nuk është aspak kanceroz. Me pesëqind belara, djali u rrit; mbushi numurin ters 13 vjet, por është keq, përvdekje. Operatorët specialistë vrasin mëndjen dit' e natë për t'i gjetur ilaç sëmundjes. Më kot; djali heq për shpirt — «gjynahet e prindërve mundojnë fëmijët».

Djali u rrit si ajo pema që ka rrënjet të helmuara. Ditën që u mbuall, një nepërkë e kafshoi. Dhe pema u zhvillua, u rrit, lëshoi vllastarë, vllastarët lëshuan degë, degët fletë dhe burbuqe; burbuqet lëshojnë lule; lulet pemë, por fruti është i hidhur. Se nëna e saj ish kafshuar prej gjarpërit. Dhe shtetet e mundur në luftën e madhe, po ushqehen me pemën e helmuar.

Gjermania është në buzë të katastrofës. Shuma e borxheve që ka për të dhënë, është astronomike. S'paguan dot, s'ka. Atje ku s'ka, s'merr as Perëndia.

Austria u katandis si një njeri me kokë të madhe që i kanë prerë këmb' e duar. Dhe kokën ja thonë

Vienë. Bullgaria dhe Hungaria janë si dy anie në mes të dallgëve pa timon, pa kapedan. Dallga e di se ku do t'i shpjerë. Traktati i Versajit s'mund të parashikojë krizën ekonomike. As traktatet e tjerë që janë këlyshët e tij s'parashikuani një epidemi aq të rrezikëshme sa dhe shkatruuese që quhet krizë. Gabin që s'falet, as ndreqet kollaj, se kush është ai trim që do të guxojë të nxjerrë botën nga anarshija ekonomike e politike ku është fundosur?

Kaizeri, për traktatin që siguronte neutralitetin e Belgjikës, tha dikur: «paçavure». Çdo traktat është «paçavure». Frëngjisht i thonë «chiffon de papier». Vlera e traktatit varet nga llogjika që përmban.

Por si të mos ta quash «paçavure» traktatin e Versajit që i hapi Europës aq plagë të pashërueshme. Koridorin e Danzingut që ka thyer mëdysht një pjesë të Gjermanisë, minoritetet etj. Gjithë këto gabime po na dalin nga hundët. Kush do të na nxjerrë nga labirinthi ku kemi hyrë, apo do të vazhdojmë «hiqe e mos e këput»? Por «kokla gordhiane»⁽¹⁾ duhet zgjidhur. Djali duhet të vdesë që të mos helmojë botën. Kush do ta zgjidhë koklën gordhiane? Në kohërat e vjetra Leka i madh e zgjidhi me mënyrën më të thjeshtë: E preu me pallë. Sot kush është ai trim me kurajo që të rifillojë zhestin e Lekës së madh? Se pallën e kemi, por dora mungon.

Gazeta e Korçës, 8.VI.1932

1) Historikisht një nyje e lidhur aq keq sa askush s'ë zgjidhte dot. Leka i madh e zgjidhi duke e prerë në mes me shpatë.

LAJME TELEGRAFIKE

Hallo Korça! Hallo! Këtu Tirana. Kabineti dha dorëheqjen. Stop. Thuhet se disa nga ministrat do të bëhen deputetë stop. Dhe disa nga deputetët ministra stop. Më ora pesë pa pesë çdo nëpunës me sahat në dorë stop. Pesë minutat e fundit u duken pesë shkuj stop.

Më çdo kafe kërcet xholi stop. Pokeri i bën konkurençë stop.

Lajme sportive: Skuadra me element legjislativ s'u formua stop. Për arësyë legjislatieve stop. Dhe se Poga⁽¹⁾ kërkonte të ish ay vetë portier stop.

Lajme fetare: Fjalimi i Aleksandër Xhuvanit rrëth shkollave laike ra si bombë në qarqet e burrave ndër të zëza stop. Por bomba s'bëri zarar stop. Se njerëzit me të zëza i mbrojn Zoti stop.

Lajme politike: Amerika kërkon paratë stop. Franca thotë s'kam! stop. Italia thotë: «s'kam» stop. Ingjilizi thotë: «s'kam» stop. Dhe Amerika thotë: «i dua» stop. Gjermani thotë: «vritni vehten!» stop. Se atje ku s'ka s'merr as perëndia stop.

Lajme shoqërore:

Rrobaqepësi më kërkon paratë stop. Gjithashtu edhe hotelxhiu stop. Dhe unë u thashë: «s'kam» stop. Se kështu tha dhe Europa stop. Mos pagimi është

1) Ministër i Zogut

nder stop. Dhe pagimi një çnderim stop. S'është një arësy që të mos paguani rrrogën stop.

Lajme ndërkombëtare: Vjehra më vdiq stop. S'e përcolla dot gjer në kishë stop. Shkaku i një hesapi të vjetër me priftin stop. Dhe s'desha gjyrylldi përpara vjehrës stop. Se ndofta e zgjonim stop. Dhe po të ngjallej ajo, duhej të vdisja unë stop. Vjehra la një zëvëndës stop. Tagrambledhësin stop.

Lajme të vëndit: Të gjithë i dinë shkaqet e krizës stop. Të gjithë shesin mend stop. Të gjithë flasin përbujqësi, por asnjeri s'ka ndër mend të marrë parmen-dën stop. Gjithëkush përpinqet përmemurlli stop. Mikrob i rrezikshëm stop. Duhen marrë masa preventive stop.

U bëj selam stop. Nga Tirana e kuqe, (më falni: e bardhë) stop.

Gazeta e Korçës, 17-XII-1932

TË DY TIRANASIT

Sa tema interesante mund të gjejë njeriu në Tirana. S'është nevoja që shkrimtarët tanë të këndojnë Viktor Hugon, Shekspirin dhe Danten, për të zbuluar Shqipérinë. S'është nevoja të kërkojmë gjurmën e një gjëje, kur atë gjë e kemi pranë.

Dhe subjekti më goditës dhe interesant, është vetë ai qytetari tiranas; ose më mirë të dy tiranasit, i riu dhe i vjetri, plaku dhe djali, ati dhe biri, perëndimi dhe lindja — bota e re dhe bota e vjetër.

Tiranasi i vjetër, këmbëkryq në fron, thith me ngutësi tymin e hidhur që shkon përmes kanalit të ngushtë të cigarishtes së gjatë dhe të bukur. I qetë, i menduar, porosit një kafe, më pas dhe një tjetër, dhe kujton kohën e shkuar. Atë kohë që iku e vajti, dhe s'vjen më. Ëndërrit, duke psherëtitur, embëlsirat e një devre anakronike dhe të demoduar. Ç'ëndërr e bukur. Zëri i motorrit t'aeroplanit e çkëput nga ëndërra e këndëshme. Një sharje kundra qytetërimit shkatërronjës dhe përsëri kredhet në lethargjin e themë të një ëndërr të brengosur.

Armiku më i madh i tiranasit të vjetër është tiranasi i ri. Djaloshi përparimdashës, që e shikon botën me sytë e këtij shekulli, që ndryshoi jo vetëm kostum, por edhe karakter, ky është tiranasi i ri. Dhe ai tiranas sundon sot në jetën sociale. Laik nga shpirti, pa fanatizëm, pa djallëzi, patriot i sinqertë, ai është

dhe duhet të jetë jo vetëm tiranasi i ri, por dhe shqiptari i ri.

— U prish bota, — thonë pleqtë, — që kur aeroplani me veturën zëvëndësuan gomarin dhe mushkën.

Dhe i riu përgjigjet:

— Pusho babë së syt e tu janë destinuar për shekullin që shkoi dhe që s'kthehet më.

Pushon plaku, dhe sytë i skuqin, me që mëndja i fluturon një shekull pas. Lamtumirë i thuaj asaj kohe. Shkoi e vajti me shekullin që perëndoi. Ikën koha dhe lë prapa kujtimin e hidhur, nostalgjinë plot farmak e mërzitje.

Gazeta e Korcës, 21-XII-1932

F L O R I R I

Një dhe një bëjnë dy; pa para s'bëhet gjë! më tha një viktim i krizës, dhe shtoi:

Kur s'të ka xhepi, s'ke as nder as lavdi, as kurajo, as fuqi, as mend. As që lind, as që vdes dot pa para. Se që të lindish duhet mami; dhe mamia do lekë. Që të vdesësh, shumë herë është i nevojshëm doktori. Dhe që të varrosesh duhet prifti. As njeri as tjetri s'të shërbejnë pa para. As doktori të jep ilaçe (që shumë herë ta shpejton vdekjen), as fetari të jep pashaportë për botën e panjohur, por të... lumtur. Diktator më të madh se paraja në botë s'ka. Flori, të falet, sot, njeriu ty, dhe vetëm ty. Ti ngreh dhe rrëzon perandırira, bën popujt të theren njeri me tjetrin, dhe skuq me gjak djelmoshash të njomë, fushat e gjelbëruara.

Paskali thotë: sikur hunda e Kleopatrës të ish pak më e madhe, fati i popuve do të ish ndryshuar. Paskali flet pér atë kohë që dashuria udhëhiqte burrat e mbëdhenj. Sot vëndin e dashurisë dhe të ambicies e zuri metali i rrallë. Interesi, përpara çdo gjëje. Pappini tregon se çifutët janë populli m'i fortë i botës, me që topave dhe mitrolozave, iu përgjigjen me dollarë dhe sterlina.

Më 1914, për disa miliarda sterlina, për një antagonizmë ekonomike midis Anglisë dhe Gjermanisë, u bë e nevojëshme të dërgoheshin në kasaphanën e kurbanit dhjet'e kusur miljona të pafajshëm. Dhe Evropa nuk u zgjua aspak nga era e qelbur që del

prej trupave të dhjetë milion kufomave. Vazhdon në lethargjin e saj plot marrëzi dhe egoizmë. Dhjetë burra, rrëth një tryze, vendosin mbi fatin e popujve. Dhe derdhin më kot fryshten e tyre, ngjiren së thirruri: «paqe paqe», dhe më së fundi ndahen për të fillouar përsëri dasmën makabre mbi kurrizin e njerëzve që vuajnë. Dhe gjithë këto dallavere, për atë të shkretë flori.

Një prift humanist fillosof i shekullit 16, Rabele, ka thënë një fjalë shumë të thellë: «Çdo gjë bëhet përbarkun!» Dhe me këtë prifti, që më von u mallkua prej kryetarëve të tij, tregon se sa materialist është njeriu, ndonëse mëndja e tij duhet të ketë tjetër preokupatë. Shkencëtarët e mbëdhej dhe shkrimtarët e shquar, që s'i japid rëndësi asaj çështjeje, mbarojnë shpesh herë ditët e tyre në burg. Shëmbell, Sauvazhi (çpikës i elixit), Dikensi, Dostoevski etj. Kur e ke xhepin plot, ke mend, ke gëzim, ke qejf... por sidomos mend? Kur je «kripë derri», je budalla i vrenjatur. Drita e diellit, shtizat e florinjtë të tij, të duken shigjeta shponjëse, helmonjëse, të zëmrës sate. Dita të duket natë, dhe nata skëterrë. Asnjeri s'ta var torbën. As bekciu i fshatit s'të thotë mirmëngjes, as nikoqirja nuk të quan burrin e saj.

Paraja është si një aktor, që mban në dorën e vet një marionetë dhe e dredh e e përdredh, e ngreh, e zbret, e flak, e puth, e pushton, e shkelmon dhe pastaj e vdes. Marioneta është njeriu. Po, zotni, njeriu i llogjikshëm. Vini re në qdo shtet: sytë kushdo i ka mbërthyer te ministria e financave. Janë mirë financat? Çdo gjë vete mbarë. S'janë mirë? S'kemi gjë. Vura re në Tiranë çdo nëpunës, një herë në muaj, e shihte të nevojshme të bënte si një biçim pelegrinazhi te arkëtari i Ministrisë së financave. Është pika nevralgjike, është shpirti, pa të cilin trupi s'rron dot.

Sikur të bënte shaka ndonjë shtet, dhe të thosh: «për arësyen ngushtice buxheti, suprimohet Ministria e financave» ç'do të ngjiste vallë? Zoti e di.

Gazeta e Korçës, 18-I-1933

SHËTITJE NË GJUMË

Njëzet e kusur minuta mbajti shëtitja ime sportive, rreth e rrotull botës. Pa para në xhep, pa pashaportë, pa valixhe, u hodha shtet më shtet, si një trim me fletë dhe u kthëva përsëri pa pësuar gjë.

Fillova nga Amerika e njomë, ⁽¹⁾ Yes, nga Amerika e Roosveltit, se kisha nevojë të zbutja gurmazin. Amerikanët as punonin, as fjaloseshin, as flinin, as këndonin. Vetëm pinin, pa reshtur, pa kursim, pa kujdes dhe kohë më kohë shanin Evropën, sidomos Francën. Gangsterët vendosën të bëhen priftër, Al Kapone peshkop, Hoveri ndreqte murin e shtëpisë me krahët e tij.

Angli, Vive England? Diçka mungon. «Ç'kérkon?» më tha një leshverdhë me gjyslyke. — «Sterlina!» iu përgjegja me buzëqeshje. «S'ka sterlina, u sosën, fluturuuan, na i muarën stërnipërit tanë të ngratë tej oqeanit».

Rusi. Çdo gjë e kuqe. Ngriheshin shtëpi, fabrika gjiganteske; pyetje enigmatike. E çdo gjë enigmë m'u duk.

Francë. S'ka, asnë grosh nuk i japim, xhaxhajt Sam. Në dashtë le të hidhet përpjetë. Ky ish bisedimi

1) Ish hequr ligji mbi ndalimin e alkolit dhe amerikanët iu dhanë pjes pa masë.

i ditës. Sheroni (¹) është ideali i ditës. Me atë mjekër si të Shën Vasilit, ka bërë be të rregullojë financat dhe të mbushë vrimën e çpuar prej defiçitit. Shkova afër «Bankës së Francës», por kundurmonte erë flori. S'e duroja dot atë erë të keqe, si ajo dhelpra që thosh, se rrushtë janë të pabërë me që s'i arrinte dot. Kabineti u formua. Këto ditë pritet rrëzimi i tij. Se kështu e do nevoja e Republikës.

Itali. Mussolini mban fjalë; duartrokitje. Këmi-shëzestë, plot gjallëri, këndojnë «Giovinezza». Krizë edhe atje si kudo. Po sporti dhe fjalimet s'i lenë kohë njeriut të mendojë hallet. Zëri i kalamaqëve, i bashkë-ngjitur me tingëllimën e kitarës dhe të mandolinës, nxirte një harmoni têrheqëse.

Bullgari. Bam-bam. Shokët e Mihaillofit (²) vrasin ata të Protogjerofit dhe anasjelltas. Ngado që vete «Off», «Off». Një «Off» lë kulltukun, një tjetër e zë-vëndeson. As atje s'u kënaqa.

Sérbi. «Dobro, dobro» — i thosh një qytetar shokut të vet, duke i treguar burgjet ku ishin mbyllur profesorët e Universitetit të Zagrebit. Desha të piqësha me një mik të vjetër. Ishte historiani që na ka pagëzuar me titullin «Sternipër të majmunit». Do t'i bëja një shaka. Do të blija një bisht, do ta futja në xhep, dhe kur t'i afrohesha do t'ja hidhja në surrat, duke i provuar se kemi vërtet bisht. Por Sérbia s'është vëndi i shakave. Një bombë në mes të qytetit, më bëri t'ja mbath me të katra.

Greqi. Venizellua bir Gjiriti, mendjehollë si petriti, dolli tekahyt. Drakmija një mijë e ca. Po grekërit ngushëllohen me Platonin. Dhe po të flasish përkritë, bërtasin «Zito i Ellas»(³).

1) Ministri i financave të Francës.

2) Kryengritës maqedhonas.

3) «Rroftë greku!»

Dhe tashti që u bëmë si plakat e liga, duke sharë tërë botën, le të kthehemë në atdhe. Pa hyrë edhe në Tiranë, pashë të shkruar në ballin e çdo njeriu, fjalën «krizë». Pashë arkëtarin e Ministrisë së financave, që kish humbur çelsat e arkës. Gjithë nëpunësit lanë punën dhe vajtën të kërkonin çelsat e uruar.

«Qënka kthyer bota séprapi», i thashë vetvetes, «mirë thonë plakat». U zgjova përnjëheresh; kur shoh para meje taksidarin, që më vizitoi nga dashuria që ndjente për mua.

Gazeta e Korçës, 21-I-1933

KRIM MË I MADH I HISTORISË

Shumë thonë, se kurioziteti i gruas për çdo gjë, rjedh prej atavizmës. Dhe është e vërtetë. Se Eva filloi proçkën e parë të saj duke mos iu bindur urdhrit të Zotit. Dhe zoti e mallkoi njerinë, e dëboi nga parajsa dhe i tha: — Vdis! Dhe qysh atëhere njeriu u bë i vdekshëm. Por mbeten disa pikë të errëta rrëth fillimit të botës, megjithëse librat e shenjta janë të kthiellta mbi këtë pikë.

Zoti bëri Evën. Tamam! Hoqi një brinjë prej Evës dhe bëri Adhamin. Bukur. Adhamin e martoi me Evën; iu lumtë. Eva dhe Adhami bënë djem dhe çupa doemos. Gjer këtu puna vajti mbarë. Dhe asnjeri nuk kundërshton. Fëmijët e Evës dhe të Adhamit u rritën dhe, helbete, duhej të martoheshin. Dhe duke u bazuar në librin e shenjtë, duhet të dimë se njerës të tjerë aso kohe s'kish në botë. Atëhere, si bëhet që prej djemve dhe vajzave të Adhamo-Evës, dolli njeriu? Natyrisht, llogjika na shtrëngon të besojmë, se vëllaj u martua me të motrën. Dhe këtu fillon krimi monstruos që rëndon mbi kurrizin e njeriut.

Bota filloi me një krim. Dilemi është i kthjellët. Ose duhet besuar që djemt'e Adhamit u martuan me motrat e tyre, ose duhen quajtur tërë ato legjenda, përralla për t'u zbavitur në netët e gjata të dimrit, rrëth zjarrit. Është pyetja më e kthiellët që njeriu mund t'i bëjë vetvetes.

Incesti quhet sot si krimi më i madh, më mostruos; morali, ligji dhe ndërgjegjja e dënojnë. Dhe kjo është shumë e drejtë. Atëhere, si bëhet që morali i njeriut të gjendet në kundërshtim flagrant me moralin qie- llor?

Ka gjëra që s'kuptohen në këtë botë. Dhe kanë të drejtë profetët që thonë: «beso dhe mos rëmo». Por ka njerëz kuriozë, që duan të dinë të vërtetën!

Gazeta e Korçës, 25-I-1933

in floskoperaq's utdelli. Óp jowdikas i si bant ja nse
ja nse kum BM fëjim ës qanitida e mështetës. Bëhet
qara qaf' arzof' faj se 'lura vënk mështid këm i si
-saga mështid le angroq' që i mështig i mështen, pës që
-fëjim mështerës i si mështide. Si mështide që s'i jep
-të mështide. - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - - -

TE GJITHA GABIME

Çdo njeri në këtë kohë s'bën tjetër veçse përpinqet të hedhë në fytyrën e shokut gabimet që i vë re.

Imiton amerikani Shejlokun¹⁾, gabim thotë Evropa. Imiton Franca Harpagonin²⁾, gabim thotë xha-xhai Sam.

Gënjen Llojd Xhorxh³⁾, Vilsonin, Jago i thotë Amerika Anglisë. Vret japonezi kinezë, krim thotë Lidhja e Kombeve.

Gjithëkush i hedh në surrat gabime tjetrit. Të paktë janë ata që hedhin sytë të shohin vetveten, përtë vënë re disa gabime elementare. Historia e gabimit i ka rrënjet thellë, në errësirat e shekujeve. Krijimi i Adamit ish gabimi i parë i pajustifikuar i zotit. Mëndja njerëzore ish gabimi i dytë jo më pak trashanik nga i pari.

«Sa më pak marrëzira do të ishin bërë në botë, sikur njeriu të mos kish mënd» thotë jo pa ironi, dikush.

Pastaj vinë gabimet e tjera që zoti (i paçim urattën), i bëri pa dashur. Për shëmbëll: përsë zoti na i ka vënë sytë në ballë? S'do të ish më mirë t'i kish ngji-

1) Fajdexhiu në Komedinë e Shekspirit «Tregëtari i Venedikut».

2) Emri i kopracit në veprën e Molierit «Kopraci».

3) Kryeministri Englez.

tur në fund të këmbëve, që kështu s'pengoheshim kurrë, dhe tokën e shihnim më mirë? Më mirë do të ish të mos kishim fare sy. Pse jo? Porsa hap sytë në saba, syfetin e vjehrrës e ke përpara si fandin spathi. Pa sy s'ishim të shtrënguar të këndonim marrëzirat e «letërnixirësvet».

Tjetër gabim. Hunda në mes të fytyrës. Gjithë atë alamet hundë! E ç'e do? Do të ish më mirë ta kishim afër xhepit, që kështu s'kish nevojë të nxirnim shaminë për ta fshirë. Pa hundë do të ish edhe më mirë. S'ishim të shtrënguar të shijonim erën e këndëshme të tymit dhe barutit, kundërmimet e kufo-mave të njoma të luftës së madhe.

Goja, është një tjetër gabim trashanik. E para, se është në vend të lik. Afër barkut s'kish nevojë të përdorej kurrë. Se goja në mes të barkut do të ish një kollajllék «teknik». E mira e të mirave do të ish të mos kishim gojë fare. Kështu problemi ekonomik zgjidhej lehtë. Pa konferenca, pa luftëra.

Po veshët? C'djall e kujtoi zotin që na dërgoi peshqesh veshët? Pér t'u kënaqur me tingullimin armonik të zërit të kalamaqit, apo për të dëgjuar psherëtimat e fukarenjvet? Mos vallë pér të dëgjuar tingullin e këmbanës, zërin e hoxhës, apo kërcëllimat e topavet? Gabim që s'falet.

Tashti, sikur t'i pranojmë veshët, s'kam arritur të kuptoj pse perëndia na bëri me këmbë. Pa këmbë, as borxhliu s'vjen dot që të të kërkojë paratë, as në gjyq s'të thërret dot; se i përgjigjesh: «zotni, s'vete dot në gjykatore, se s'kam këmbë, dhe faji s'është imi, duhet dënuar krijonjësi». Po të të thotë vjerra: «shko na bli sheqer, kafe, oris, vajguri, misër»; ke sy e faqe t'i përgjigjesh: «me gjithë qejf do të viaj moj motër, por me kokë s'mund të eci». Kështu që hem vjerrës ia bën qejfin, hem para s'prish.

Përsa u përket duarve, besoj se jemi të gjithë në një mendje. Është gabim i madh, që pati rrjedhjet më tragjike. Pa duar, as traktati i Versajit s'do të ish nënshkruar. Pa duar s'kish si të vuanim duke kënduar marrëzitë e pakuptueshme letrare, që të sëmurin dhe të dërsitin. Pa duar s'do të këndonit këto radhë të mërzitëshme. Është e vërtetë se ka shumë njerëz që «shkruajnë me këmbë», por aty s'kam ç'bëj.

Këto janë gabimet, mor zotni. Mjerisht ne jemi komplet me gabime; kemi kokë, sy, veshë, hundë dhe duar. Asgjë s'na mungon veç lekëve. Dilemi është tragjik: — të jesh ose të mos jesh, siç thotë Hamleti. Çdo njeri është pak a shumë Hamlet. Të jesh, është keq, se s'di pse erdhe në botë, përse rron dhe për ç'arsye ikën siç erdhe. Të mos jesh, është keq, se s'di në do të shijosh dot xhenetin e lulëzuar. Gabim, gabim, është njeriu në botë. Muhameti tha: «çdo njeri është i marrë gjysmë ore ditën». S'ka arsyе që thënëja e Muhametit të mos aplikohet te ay që na dha ymër. Atë gjysmë ore që na krijoj zoti ose ish i dehur, ose s'ish tamam, për një arsyë a një tjetër. Dhe njeriu s'është gjë tjetër veçse një shkëndijë e shkëputur gabimisht prej shkëndisë hyjnore.

Gazeta e Korçës, 26.I.1933

KËNDERA E KËNDËSHME

Vajta në Tiranë! Përse vallë? Mund t'i kërkonit shpjegime vjehrës; se ajo më nisi për në kryeqytet. Nuk e di se ku djall kish marrë vesh se ndodhet vakant një vend ministri. Ndofta ja kish hedhur në vesh prifti, ndofta e kish parë në «gazetë» vetë. Sidoqoftë, një mëngjes më urdhëron të ikëj, dhe unë, singa hera, iu binda urdhërit. Erdha vërdallë nëpër Tiranën e njomë, u vërtita se mos ngjyrosja dot vendin vakant, por më kot.

Mund të thotë dikush: «ambicios, shumë larg vë-shtroke». Atij teveqeli i përgjigjëm: Është mantalitet ballkanik, që s'refuzon njeri kultukun, qoftë edhe atë të ministrit. Fundi fundit vjehra ka të drejtë; pse jo? S'jam dhe unë njeri? Cili është ai që i kanë thënë «bëhu ministër» dhe ka thënë «jo?» Vetëm Nastradini s'desh të bëhej dhespot, në kohërat e shkuara.

Neise, le ta lëmë Nastradinin dhe të kthehemini në punën time. As iu luta, as më propozoi njeri për ministër. Sikur të më kishin ftuar do ta pranoja me sy mbyllur. Nga dëshpërimi mora «defterkën e vok-kël», siç thonë korçarët, dhe me një kalem të blerë vëresie, mbajta shënimet që vijojnë:

Nëpunësit, kur bën ftohtë, qahen se s'u bëjnë duart të shkruajnë. Kur bën vapë, u dërsijnë gjish-térinjtë dhe u shket pena nga duart. Duhen marrë masa «primitive», desha të thoshja preventive, por u gabova; dhe s'jam i vetëmi. Deputetët vara-vingo në

parlament. Bisedojnë pa reshtur. Një korçar ua tha copë: «s'është koha të bisedojmë gjëra të kota. Duhet vepruar». Një tjetër i përgjigjet, se s'është bisedim i kotë, të bisedosh gjëra të kota; dhe mbledhja vazhdon.

Qeveria e re e ka marrë punën me zell. Nga Ministria e financave presin lekë dhe rrugët në financa; nga e botores, rrugë prej hekuri, jo prej balte; nga ajo e ekonomisë, bukë, qoftë dhe prej misri; nga e drejtësisë, presin drejtësi, dhe nga ajo e arësimit, kulturë kombëtare pa influenca idesh anakronike dhe të padobishme.

Siq e kishim parashikuar, me rënien e kabinetit, disa ministra u bënë deputetë, dhe disa deputetë ministra. Disa venë në zyrë më këmbë, disa me veturë; kështu e ka kjo botë: herë ma hipe, herë ta hipë. Mirë, po unë s'hipa një herë, dhe kështu s'di me ç'sy e faqe do t'i paraqitem vjehrës, Nikoqires et Cie.

Gazeta e Korçës, 1.II.1933

INTERVISTË ME MALESORIN

E parashikoj buzëqeshjen ironike të intelektualit (siç) që mendon se një malok (siç i thonë ata me kulturë të bastarduar), s'vlen as për intervistë, as për t'u përfillur. Ndofta të paktë e thonë këtë gjë, por shumë e mendojnë.

E di fare bukur, se përgjithësisht intervistat u merren atyre që janë politikanë, deputetë, ministra, poetë, romancierë ose fillosofë. Javë për javë shohim në gazetat: Intervistë me Heriotin⁽¹⁾; intervistë me Lloyd Georgein⁽²⁾, me Hooverin⁽³⁾ etj. Unë prefero-va të mos shqetësoj as deputetët, as ministrat. S'vajta as te kryepeshkopi, as te kryemyftiu për intervistë.

Një shëtitje e shkurtër, gjatë rrugës së vjetër të postës, mjafton për të zbuluar krizën e kryeqytetit. Atje trazova me gjishtrinjtë mi telat me tinguj tragjikë të zëmrës së përvorjtur të Tiranës. Atje, tek një rrugë e errët, e vrenjtë, e ngushtë, dëgjova pshëritimën e malësorit. Njëqind e kusur fshatarë, prej gjithë viseve të Shqipërisë, pritnin që Ministria e ekonomisë t'u jepte shpërblimin për punën që kishin kryer. Dhe më vonë këndova në gazetë se disave u dha.

1) Politikan frëng.

2) Diplomat anglez.

3) Ish president i Amerikës.

Me fytyrën e tyre të veshur, me ballin rrudha rrudha, me ata sy të futur thellë, ku pasqyrohej një helm që e ndjen por s'e thua, dhe që gjellosolllogët i thonë uri, me ato xhoke flokë-flokë, të zeza, me rretra të grisura, me brekushe jo prej stofe angleze, ishin shtrirë malësorët e përvojtur dhe soditnin njerëzit e rrallë që kalonin.

S'vihej re në buzët e tyre, as buzëqeshja legjendare, as krenaria e zakonëshme. S'kishin as kravatë prej mëndafshi, as doreza, as borsalino, as monokle, as bastun. Duart e tyre s'binin erë livando; s'dinë të shkruajnë as të këndojojnë, por dinë të vuajnë. Njeri prej tyre më tha se ka fëmijën pa bukë dhe gruan me barë. Më mori për njeri të madh, e m'u lut t'iuh shpejtohej pagesa. Shumë njerës shkonin me bakllava nëpër duar (se ditën tjetër ish bajrami), por bënин sikur nuk i shikonin njerëzit e maleve; kur vjen puna përmbrojtjen e atdheut, kur vjen puna përmbringtur flamurin dhe interesin, fshatari është gati. Unë e ti mor këndonjës i dashur, në kohë lufte futemi nëpër bodrume; dhe kur bëhet paqja bërtasim: Rroftë Shqipëria! Dhe akuzojnë malësorët si vjedharakë dhe gjenjeshtarë. Kurse e vërteta është se malësori, në vjedhë, vjedh një kec që bën dhjetë lek. Unë e ti, kur vjen rasti, vjedhim një kope me deshë me këmborë e me gjithë bari... Këtu qëndron ndryshimi.

Gazeta e Korçës, 9-II-1933

S P O R T I ? !

Me një grusht të hekurt, Goliadhi italian, Karrera, shtriu përdhe të vdekur kundërshtarim e tij, Shaaf. Sportistët e tërë botës duartrokitën Karne-rën pér fuqin e tij. Është një rast i mirë të flasim pér sportin. I biri i botës ble një radio, më shumë pér të marrë vesh përfundimet sportive, sesa pér të dë-gjuar nonjë pjesë muzikore.

Fjala sport ka, dhe duhet të ketë, dy kuptime. Sport do të thotë për disa, thyerje kokash, këmbësh, vrasje (shumë herë për të shpëtar nderin e atdheut). Dërguan dikur një gazetar frëng antisportist, për të asistuar në një match, rugby, midis Francës dhe Anglisë. Kur mbaroi ndeshja, gazetari i telefonon gazetës përfundimet e ndeshjes: «Hallo, përfundimet janë këto: dymbëdhjetë gishtërinj të thyer; katër ko-ka të çara, prej të cilave njera s'ka shpëtim; shtatë këmbë të gjakosura dhe tetë brinjë që duan me doemos operacion». «Hallo, hallo!» Administrata e gazetës i përgjigjet: «Hallo, na jep përfundimet sportive të plota. Dhe gazetari ua kthen: «Hallo! Thonë se anglezët duallë fitues, por unë s'besoj; dhe kam arsyet: në luft' e sipër, sipas hesapit që bëra, nga të shtatë këmbët dhe katër kokat e thyera, gjashtë janë anglezë. Kështu që anglezët s'dualën fitues, me gjithë që bota e besojnë».

Këto tha gazetari frëng, dhe qysh atëhere gazeta nuk e ngarkoi me detyra sportive.

Ky është kuptimi i parë i fjalës sport. Për shumë të tjerë, sport do të thotë forcim i trupit, i musklave, me rregull, me masë, lodër miqsore, pa pasjon, pa prapamendim lokalizmi. Ata që mendojnë kësisoj janë të paktë. Shumica më duket se janë sadistë. Një dem që çan zorrët e një djaloshi, një grusht i hekurt që nxjerr trutë nga koka, janë emocjone të këndeshme.

Një dekadencë e tillë e intelektit njerëzor, në vitin 1933, është vërtet tragjik. Karnera, Orsi, Tunney, Damsay, Karpentier, Polena, Sturgis (¹) etj. janë idolët që krijojnë emocjone në popujt e qytetëruar të perëndimit. «Shtaza», «la bête», siç thotë Paskali, e vdiq mendjen. Tallet Europa krenare me popujt fanaticë dhe të paqytetëruar të Lindjes; por fanatizma fetare e Indit, është zëvëndësuar në Europë me fanatizmën sportive. Ka vajza në Lindje që mbajnë pranë zemrës fytyrën e Budës. Vajzat europjane dhe djemt, preferojnë Karnerën, Zamoran. Më duket se një marrëzi balancon tjetrën. Këtu qëndron puna. Bir Selman i nënës, ç'të të qaj më parë! Në këtë rast Selmani është... qytetërimi.

Gazeta e Korçës 4-III-1933

1) Boksjerë dhe mundës të kohës.

MASKA TE ÇJERRA

Dhe karnavalet do t'i festojmë.... etj. Si jo? Duhen dhe ato. Bile janë të domosdoshme. Ne mund të themi: «Sikur të mos egzistonin karnavalet duhej t'i çpiknimit».... Se është një festë jo si të tjerat. Origjinale, në esencën e saj, dhe krejt misterioze në origjinë. Shumë shpjegime i kanë dhënë, por pa bazë të fortë historike. Një maskë, një fustanellë, një palë opinga, hipur në gomar.... dhe ja karnaval!

Pse e sheh të nevojshëme njeriu të bëhet qesharak një herë në vit? C'është ky zakon i çuditshëm? E vërteta është se, cilido, është pak a shumë qesharak. Kushdo ka dobësitë e veta intime, thellë në dejet më të fshehta të zëmrës, që s'i tregon kurrë; ka frikë mos bëhet qesharak. I ruan ato dobësi, dhe kur vdes, i varros bashkë me trupin e tij. Mos karnavali është një alegori e jetës? Jemi në fushën e hipotezave. Kemi të drejtë të rëmojmë për të shpjeguar këtë kremtim origjinal. Qeshim kur shohim një njeri karnaval. «Shiko ç'fytyrë»! i themi njeri tjetrit. Kush na siguron, se ajo fytyrë, s'është fytyra e vërtetë e tij? S'them mi dot se jo.

Një sy, në thellësirat e shpirtit tënd të bën të bindesh. E di që është më lehtë të qeshësh me tjetrin, sesa me veten tënde? Një sy i sinqertë, për të soditur pjesën komike të zemrës, është gjë e vështirë, por e nevojshëme.

Do të ish interesante një karnaval, ku qdo njeri të zbulonte të metat e veta në mënyrë alegorike. P.sh.: një fajdexhi të kish në ballë një nepërËkë që thëthin gjakun e foshnjave; dhe fajdexhiu të kish në fytyrë një maskë, pér të mos u ekspozuar.

Një dipllomat të kishte të shkruar në gjoksin e vet sa herë ka thënë të kundërtën e atyre që ka besuar. Është e vërtetë se gjoksi i tij duhej të ish i gjërë e i lartë sa një mal.

Një nga ata, që përpilen pér çarmatim, sikur të vishesh si Marsi dhe në dorën e djathtë të mbante një top (prej karte natyrisht), në tjetrën një mitroloz (prej mukavaje, se ndryshe bënte zarar) dhe me dhëmbët të mbërthente një grua shumë të bukur që ta quanin Paqe. Kohë më kohë ta kafshonte atë grua (gjoja sikur e puthte). Natyrisht se gruaja duhej të ish shumë e bukur, pér të qënë e vërtetë. Ashtu siç është paqja e Gjenevës.

Çdo tregtar do të delte karnaval, me një ballancë, dhe të nëmëronte publikisht, sa herë ka shitur killon pér okë, kutin pér metro, rakinë me ujë, ose më mirë ujët me raki.

Çdo prift a hoxhë (me ato rroba që vishtë pér dita), të eksposonte publikisht, sa herë ka qënë i shtrënguar t'u thotë besnikëve, gjëra pa i kuptuar as edhe ai vetë.

Do të ish një kryevepër, kur gënjeshtari të vinte maskën e gënjeshtarit, hajduti të hajdutit, hipokriti atë të Tartufit dhe intriganti atë të Jagos.

Do të quhej «karnaval sinqeriteti». Dhe asnjieri s'do të guxonte të qeshte me të tjerët, se do të kish dhe ai vetë të metat e tij.

Një konfesion publik, siç e bëri Raskolnikoffi (¹),

1) Personazhi i Dostojevskit më veprën e tij «Krim e ndëshkimi»

do të ish diçka origjinale. Po Raskolnikoffi s'ekziston veçse në përfytyrimin pjellor të Dostojevskit. S'ka njeri që të çveshë lakuriq shpirtin e tij, dhe të thotë: kaq herë kam qeshur, kaq herë kam gënjer, kaq herë kam sharë. Do të ish një karnaval tragjikomik.

Kur them «s'ka asnjë» nuk e tepéroj. Ndofta Rusoj, në konfesionet e tij, iu afrua. Përshkroi jetën e tij, ashtu siç ish jetuar, prandaj jeta e tij është «shumë e vërtetë, për të qënë e bukur». Mijëra shkrirtarë kanë përshkruar jetën e tyre, por ajo jetë s'është mjaft e bukur, për të qënë e vërtetë.

Dhe kur ajka e mendjes njerëzore, shtrembëron shpesh herë të vërtetën, si do të jetë e mundur që njeriu i rrugëve ta tregojë «të vërtetën?» S'është e mundur! Fjala «sinqeritet» u bë dhe ajo për të zbuluar muzetë, si fjala «lumtéri» dhe «dashuri». Këto tri fjalë, që mjaftonin për ta bërë xhehnemin xhenet, shkuant e vanë.

Dhe karnavali u festua, si ngahera pa interes. S'ish veç një karikaturë e karnavalit të vërtetë. Dhe s'mund të ngjiste ndryshe.

Gazeta e Korçës, 5-III-1933

ORATORI

Ishte dita e Flamurit. Duhej të mbaja një fjalim. Fshatarët më ishin lutur. Dhe mua ma donte pakëzë qejfi. Dëshëroja «duartrokitje» dhe «bravo». Vit për vit e mbante dhaskali atë fjalim. Sivjet dhas-kali ish sëmurë. Dy ditë më parë hodha një sy në fjalimet që janë mbajtur në vitet e shkuara. Hapa gazetat dhe këndova një natë të tërë. Dhe pak nga pak u bë fjalimi vetvetiu. Zati, s'është zor një fjalim. Me dhjetë fjalë, fjalimi është gati. Cilat janë këto dhjetë fjalë? Të gjithë i dini. Në çdo «llogo» mjafton të përsëritësh dhjetë herë fjalën «popull», dymbëdhjetë herë fjalën «plaku i thinjur», pesëmbëdhjetë herë «zin-xhirat shekullorë», shtatëmbëdhjetë herë «barbarizmat turke», njëzet herë «rroftë Shqipëria», njëzet e dy herë «Ismail Qemali» dhe dyzet herë «Vlora kresh-nike». Bëni provë dhe do të bindi. Kështu e bëjnë shumica e oratorëve, dhe e hedhin lumin përtetj... siç e hodha dhe unë. Nuk përpinqemi të themi diçka origjinale, e gjejmë më lehtë të imitojmë të tjerët. S'është zanat i keq të jesh orator!

Një tryezë para meje, një gotë me ujë, një tufë lulesh dhe qetësi... «Popull fisnik! (dy minuta mendim, se harrova fillimin): Dita e sotme, është ajo ditë në të cilën plaku i thinjur... (piva një gotë ujë), ngriti flamurin kuqezi, në Vlorën Kreshnike (duartrokitje). Popull, kjo ditë e shenjtë, na tregon (këtu

e humba toruan). Si Ismail Vlora, plaku i thinjur, me atë dorë të çeliktë, na çkëputi nga barbaria turke. (Duartrokitjetë nxehta, entuziazmi mbretëron, fillova të entuziazmohem dhe unë). Popull, një mëndje e mprehtë e diplomatit plak të çlroi prej armikut. S'ka si kjo ditë, o popull fisnik. Atje në buzë të Adriatikut, në qytetin kreshnik (theksova fjalën kreshnik, që të kem kohë të mendohem) të Vlorës, atje është... (këtu mendova pak, se nuk më vinte ndër mend fjala «djep») djepi i Shqipërisë» (Bravo, bravo, rroftëëë...).

Dhe këshfu, një or' e gjysmë rrësht, vazhdova të goshtit popullin e fshatit, me xhevahiret e paçmuara, që çkëputeshin prej buzëve të mia. Dhe kur mbarova, të gjithë më siguruan se fola më mirë nga dhaskali. Ajo që më ngushëllon, është se s'jam i vetëmi, që kam talent oratori...

Gazeta e Korçës 8-III-1933

SHOSHA E ARIXHIUT

Çdo vend, pa përjashtim, e ka zakon të lavdërojë veten e tij dhe me argumenta, pa k a shumë artificiale, përpinqet të provojë se vetëm ai është i thjeshtë, fisionik, altruist, paqedashës, trim dhe i singertë. Ky zamat i të lavdëruarit të vërvetes është si ai zanati i arixhiut që lëvdon shoshën e vet. Por arixhiu ka të drejtë ta lëvdojë shoshën, se ndryshe s'ja ble njeri; kurse popujt, s'kanë ndërmënd të shesin vatamin e tyre. Këtu qëndron ndryshimi i një arixhiu me një shtet.

Amerikani trumbeton, se shteti dhe populli i tij është ai më me fuqi «dinamike» në botë. Yanke s'don të besojë që Europa zbuloi dikur Amerikën. Dhe jo vetëm kaq, por ka dhe pretendimin, se pas pak kohe do të zbulojë ai Europën; dhe s'është çudi që një ditë, Amerika «të zbulojë» gjyshen e saj plakë, pa mëshirë. Dhe kur them «ta zbulojë», dua të kuptioni fjalën ta «çveshë» lakuriq. Borxhet do të shërbejnë si mjet i një «zbulimi» të tillë. Kështu që Amerika zbulon Europën me borxhet, kurse Europa e zbuloi me gjeminë e Kristofor Kolombit. Po ka një ndryshim.

Kur Amerika flet kapriçioze, japonezi arrogant hidhet e thotë:

— Unë, populli më i fuqishëm i botës, s'kam dalë kurrë gjer sot i humbur në asnje luftë. Është dëshira

e Perëndisë, që japonezi të zaptojë botën, për ta ndriçuar me kulturën e tij të shkëlqyer, hyjnore. Tha një prift japones: «Lufta kundër Kinës është lufta e qytetërimit kundër errësirës. Kur të zbusim Kinën, do t'i biem Amerikës, Rusisë dhe pastaj Europës».

Bolsheviku ja pret fjalën në mes japonezit arrogant, dhe flet me optimizëm: — bota e vjetër u kalb. mori erë. Ne rusët, jemi gati t'i vemë themele të reja. Kultura kapitaliste është e bastarduar. Paraja u mblohdh në disa duar dhe popujt vuajnë.

— Si the, si the? — përgjigjet Franca republikane. — Ku ka si parajsa republikane? Liri, vëllazëri, njëjësi. Bota duhet të ushqehet me këto tri ide. Ja kemi dhuruar qytetërimit qysh prej vitit 1789. Kryengritja rrëzoj monarkinë (dhe polli Napoleonin), dhe bota shpëtoi. Pretendime imperialiste s'kemi vecse, përsa i përket letërsisë. Shekulli i 17, 18 dhe 19, a nuk mjaftojnë për të justifikuar një pretendim të tillë? Jemi fisnikë, krenarë, trima dhe paqedashës.

— No signore, — thotë italani, — Italia ka më tepër arsyë të flasë për imperializmë intelektuale. «Rilindja», që nxori piktorët, skulptorët dhe poetët më të shquar, e forcojnë një pretendim të tillë. Roma, që zaptoi dhe qytetëroi botën, a nuk ish stërgjyshja jonë? Kultura latine, cilin vazhdues më të denjë se ne mund të linte pas? Jemi shteti më fisnik, më trim, më paqedashës i botës.

— Ohi, Qirie⁽¹⁾, — thotë greku megalloman. — Kultura romane është e vjedhur prej nesh. Ne jemi populli më fisnik, më i vjetër, më krenar dhe më i kulturuar i botës. Platoni, Sokrati, Aristoteli, mjaftojnë për të na besuar.

1) Jo!

Mirëpo Sërbia, flet dhe ajo për paqe, për fisnikëri, për kulturë, për sinqeritet.

Nga të gjitha këto, dueli anglo-gjerman është më i bukuri.

— Ne, — thotë anglezi, — populli më i fortë i botës, kemi mundur të qytetërojmë katër qind miljonë njerës. Imperatoria angleze i dha grushtin më të fortë imperatorisë barbare të Kaizerit.

Gjermani, i inatosur, përgjigjet: — Populli ynë është i zgjedhuri i zotit. Hitleri është Krishti i shekullit 20. Çpikjet më të mëdha, topat më të mëdhej, (që shërbijnë për të vrarë njerës të paqytetëuar), kultura më e thellë, filozofia më e qartë (për shembull Kanti që shquhet për qartësinë e tij), janë gjermanë. Idetë më zheniale, të vërvitura në botë për ta ndriçuar, kanë dalë nga trutë gjermane. Anglezët s'kanë gjë prej gjëje.

Stërniprit e Disraelit dhe të Pittit përgjigjen pa një pa dy:

Kultura? Ku e ka bota një Shekspir? Një Bajron?

Gjermani ja pret: — Ku ka bota një Gethe, një Haine?

Dhe kështu dueli vazhdon. Harrova të themi që, as gjermanët, as anglezët nuk harruan të thonë se janë më fisnikët, më të vjetrit dhe më paqedashës në botë.

Gazeta e Korçës, 10-3-1933

STATISTIKA

Oratori më i madh i shekullit njëzet nuk është as Hitleri, as Herioti. U provua se statistika është më elokuente nga çdo gjë. Natyrisht një statistikë autentike.

Për shembull: Kush e humbi, ose kush e fitoi luftën e 1914-ës? Historia thotë: Franca, Anglia edhe Co, dhe e humbi Gjermania, Austria edhe Co. S'është e vërtetë. Ose më mirë s'është e saktë.

Arësyet: Çdo ushtar i mobilizuar kushtoi, simbas statistikës, 400.000 fr. franceze. Bëni hesap sa miliona ushtarë ishin ftuar në dasmën makabre; shumëzoni, pastaj pjestoni dhe do të gjeni këtë gjë të çuditëshme. Nga këto 400.000 fr. shpenzime për çdo ushtar, 250.000 i muarën ata që fabrikojnë topa, dyfekë dhe fishekë, Krupi dhe Shneideri. Njeri freng, tjetri gjerman. Këta ishim fituesit e luftës së madhe. Që të dy, pa ndryshim nacionaliteti, shisnin xhepane, ne njeri ose tek tjetri shtet. Punëtori gjerman punon në fabrikën Krup. Nxier dyfegje. Franca ble ata dyfegje. Dhe lufton me gjermanët. Punëtori freng punon në Shneider. Nxjerr mitroloza dhe bomba, që do t'i blejë Gjermania për të vrarë francezët.

Këtu qëndron puna. Gjer në këtë pikë ka arritur qytetërimi i bastarduar. Krupi dhe Shneideri janë të krishterë. Falen rregullisht. Bëjnë sevap. Dhe marrin bekime. Dhe pastaj, fluturojnë në aventurën çnjerëzo-

re, fabrikojnë, aq sa s'kanë q't'i bëjnë. Janë si ai doktori që s'ka punë as myshterij, se s'ka sëmundje. I lutet zotit doktori të dërgojë në botë të paktën ethet, që të nxjerrë kafshatën me termometrin e vet. Krupi dhe Shneideri, q'do t'i bëjnë gjithë ata hekura sikur paqja të mbretërojë në Europë? Patkoj pér mushka, apo so-ba pér t'u ngrohur? Ku do të venë gjithë ata fishekë, veçse në mishin e njeriut? Dhe bombat mos do të shërbijnë pér të vrarë peshk? Nuk besoj!

Të 1600 vagonat që vinin pér në Hungari, nuk ishin ngarkuar me ftoj dhe me mollë. Ishin plot me municione. Dhe mijëra të tjerë, që gjithashtu, nga Austria venë në Beograd, nuk janë mbushur as me stofa, as me portokalla. Statistika është gati t'ju sigurojë pér një gjë të tillë.

Dy bloqe në Europë. Dy vullkane gati pér të plasur. Do të përpiken? Dhe në atë përpjekje, do të bëhen déme «të vogla», dhe qare të mëdha. Dëmet janë pér tërë botën, qaret pér dy veta: Krupin dhe Shneiderin. Sa do të fitojë njeri, sa tjetri, nuk e dimë. Vëtëm jemi të sigurtë, se mishi i njeriut kushton shtrejtë. Bëj hesap, 400.000 fr. një ushtar. Shumë shtrenjtë. Në luftën që po na turret, s'dihet me siguri vlefta e vërtetë. Statistika do të na e tregojë dhe atë. Mos kini merak!

Gazeta e Korçës, 18-III-1933

T U T J E - T E H U

Japonia lufton Kinën I turret Europës së bardhë dhe Rusisë së kuqe. Lidhja e kombeve falimentoi. Europa s'guxoi t'i thosh Japonisë: «Mjaft!»

Bolivia me Paraguain po theren. Dy shtetet Veniamine duan të lozin rolin e Goliadhit.

Dollari është duke bërë «kollotumba». S'dihet me siguri shuma e viktimave.

Hitleri merr fuqinë. Burgos, pa ndryshim, komunistë, socialistë, katolikë dhe çifutë. Gjermania udhëton në kaosin e vrejtur.

Anglia herë e burgos, herë e çburgos Gandhin stoik; herë e lëshon, herë e ndjek, herë e puth, dhe shpesh e kafshon; nga ndonjëherë, kavaleria engleze, capit mbi trupa kufomash të gjalla.

Franca alarmohet prej lidhjes Italo-gjermanohungareze. Po lidhja përgënjeshtrohet. Dhe Franca nuk qetësohet.

Antanta e vogël dridhet e përdridhet, bën konferencë, proteston kundra armatimeve hungareze.

Ballkani gjëmon. Jugosllavia ka dy plagë të pashterueshme: Kroacinë dhe marëdhënjet me Italinë. Mungon heqimi për të shëruar ato dy plagë. Është frikë mos bëhen gangrenë.

Greqia, s'di ç'bën. Ka gjetur një plak diplomat, kur e vë në fron, kur e ndjek, kur e bën perëndi, kur e përbuz, kur e hipën në qiell, kur e fundos në dhe.

Mirnjojtja nuk është aspak karakteristika e popullit grek. Atavismë.

Në Rumani kabinetet ngrihen e bien si pelivanë. Gjë që s'provon aspak prosperitet ekonomik ose politik.

Shqipëria, sikur të lëmë më njanë krizën, është më i qeti i Ballkanit.

C'hipoteza të bëjë njeriu? Ku vemi? Si i ka hallet kjo botë jallane? Anarhija ekonomike-politike kur do të marrë fund? Kohërat e profetëve ikën e vanë.

«Në një spitale të marrësh, ku vetë doktorët e shquar janë sëmurë, si mund të shërohen të tjerët?»

Gazeta e Korçës 21-III-1933

HISTORIA E BOTËS ME GJASHTË FJALE

Udhëtimet e diplomatëve Londër, Paris, Romë e vice versa, nuk e bindin dot njerinë, se mund të sjeillin ndonjë mbarësi. Opinion i ngop me konferanca dhe udhëtime të tilla. Dhe fruti i tyre gjë sot ka qenë si ai i xhenetit që helmoi Evën. Shitetjet e Macdonaldit (¹) nëpër kapitalet e Europës, fjalimet entuziastike të Boncourit në Gjenevë, s'e bindin dot njerinë të besojë në paqë. Ka njerës që e duan sinqerisht paqen. Kababallarë që janë paqifistë nga frika mos vritet biri i tyre në luftë. Një paqifizëm i tillë është hipokritëgoist.

Ka njerës që sotpërsot s'besojnë në paqen. P.sh. Hitleri. Ka njerës, për të cilët fjala page s'ka asnje kuptim. Dhe ata bazohen në natyrën, në kafshët. «Ç'do gjë është luftë në botë», — thonë ata. I madhi vret të voglin. Luani çan ujkun. Ujku çan qenin. Qeni ha lepurin. Peshku i madh ha të voglin. Dallandyshja ndiqet prej shkabës, dhe miza prej dallandyshes. Çdo gjë është luftë. Lufta për jetën. Dhe nuk është aspak në pozitë mendja njerëzore të çdukë luftën për jetën.

Kjo teori e luftës së përjetëshme, ka dalë prej një shkrimtari frëng të shekullit të shkuar. Në mos gabohem, emri i tij është Xavier de Maistre. Na-

1) Kryeministri anglez.

tyrisht që japonezët janë me një mendje. Fjala paqe s'gjendet në fjalorin japones. Gjë që s'do të thotë se Xavier de Maistre dhe japonezët kanë të drejtë. Ajo që është e sigurt, është fakti se qytetërimi po bastardohet. Të besosh se lufta është e përjetëshme, është një sharje ndaj logjikës dhe ndërgjegjes së botës.

Kristianizmi çduku skullavérinë. Është e vërtetë. Por, pse s'flet për skullavérinë tjetër, që quhet kolonializëm? S'ka paqë gjer sa një popull sundohet prej tjetrit; francezë dhe anglezë, sundojnë pesë herë më tepër popuj nga ç'janë vetë. Me ç'të drejtë? Për t'i qytetëruar? Ndofta. Por më tepër për kauçuk, xhevahire, banane dhe flori. Interes, pastaj ndërgjegje. Pakicat që sundohen prej shumicave, s'janë aspak «atout-ra të sigurta për paqen. Përkundrazi, «Pvogli shtypet prej të madhit». Kjo është gjer sot përbledhja me gjashë fjalë e historisë së përbotëshme.

Gaz. e Korçës, 30-III-1933

JALLAN SHAHITET

Të gjithë, shpejt a von, do të shkojmë kokë-
ulur përparrë gjyqtarit hyjnor dhe do të betohemi,
se sa kohë kemi jetuar, kemi qënë të drejtë (si dra-
përi). Që gjyqet e kësaj bote janë të mbushur me
jallanshahitër, është e sigurt. Por si do ta gënjejmë
Zotin, kurse ai e di të vërtetë? Mund të thotë
dikush, se s'është e nevojëshme të na gjykojë ai gjy-
katës që e di të vërtetë. Mirë po, shumë thonë
se gjyqi qiellor na pret të gjithëve. Dhe ja, me pak
fjalë, betimet e jallanshahitetëvet para Zotit:

Deputeti, do të betohet se s'ka ngritur kurrë
gjishtin, as kur ish në shkollë fillore, as kur ish në
parlament.

Nëpunësi, do të sigurojë gjykatësin qiellor, se
s'ka trazuar kurrë letra kumari me dorë.

Prifti, Hoxha dhe Hahami, do të betohen se s'ka-
në gjenjyer kurrë në botë. Dhe, për ta siguruar Zotin,
do të nxjerin shahitë avukatët.

Diplomatët do t'i japid fjalën e nderit, se nuk
e njojin kuptimin e fjalës «dhëpëri».

Gazetarët, do të venë dorën mbi ungjill e mbi
kuran, për të siguruar gjykatësin, se duke dashur të
mbushnin mëndjen njerëzore me shkrimet e tyre,
mbushin gabimisht xhepat e veta.

Doktorët do të betohen, se s'i kanë dhënë kurrë
kinino njeriut që vuan nga syri. Do të betohen gjith-

ashtu se s'kanë pasur kurrë dëshirë pér t'u bërë deputetë.

Tregëtarët do ta sigurojnë atin qielor se nuk e kanë shitur kurrë okën treqind.

Pasanikët do të çfaqin me ndërgjegje, urejtjen e tyre kundrejt parasë.

Fukarenjtë do të betohen se s'kanë vjedhur kurrë, qoftë dhe nga uria.

Dhe më së fundi, tagrambledhësi do të jetë jallanshahiti i fundit që do të gënjejë «Padronin» duke i çfaqur me lotë në sy, dhëmbshurinë pér popullin.

Ky është në përbledhje, procesi tragjikomik, që një ditë do të bëhet në bahçen e lulëzuar të Parajsës. Do ta bindin dot Jallanshahitet «Padronin?» Këtu qëndron pikpyetja.

Gazeta e Korçës, 27-IV-1933

P E R S E K U T I M E

Duan të thonë, se qysh prej ditës që u kryqos Krishti, ra mbi çifutët e gjithë botës një mallkim qiellor. Dhe qysh atëhere bota e krishtere i quan si fajtorë, që s'kanë ç'bëjnë tjetër në këtë botë, veçse të lajnë krimin çnjerëzor. Nuk di në ka vleftë mallkimi qiellor. Por një gjë është e sigurtë: Kudo që ka çifutë, ndiqen. Fanatizmë? Interes? Ku ta dish! Polonia s'i qas nëpër universitetë. Lituania përpinqet t'i dërgojë në Palestinë. Rumania i përbus, se i quan të rrezikshëm dhe jo besnikë. Një gjë është e sigurt. Se çifutët s'kanë dhëmshuri për shtetin në të cilin rrojnë. E dinë që luftohen prej fanatikëvet. Luftë për luftë. Jo vetëm krishterizmi, po edhe myslimanizmi i lëfton. Prandaj egziston midis çifutëve të të gjithë botës një lidhje. Dhe ajo lidhje është kundra gjithë botës, nëqoftëse bota është kundra çifutit. Parancë dhe mëndjen, dy faktorë të domosdoshëm për shoqërinë e sotme, çifuti i ka. Dhe me ato lufton.

Hitleri hipët në fuqi. Dhe bëri be të pastrojë Gjermaninë prej gangrenës çifute. Vrau, preu, burgosi, rrëmbue pasurira.

Veprimet e Hitlerit s'janë aspak «hynere» përtu imituar. Përfytyroni Albert Einsteinin (çifut), fizicienin më të madh të shekullit, të ndiqet prej bojaxhiut Hitler. Përfytyroni Max Reinnardtin, një nga aktorët dhe regjisorët më me famë të Europës, të nda-

lohet të çfaqi në skenë. Sauerbruch, operatori që nderonte Gjermaninë, u shtrëngua të japë dorëheqjen. Tre yj të Izraelit që shkëlqenin mbi qiellin gjerman, u shuan. Ata që prej kohe nderonin atdheun e tyre, sot dbohen si qenër. Kështu tregohet mirnjohtja në shekullin 20. Nëqoftëse hitlerizmi është një doktrinë politike, ç'faj ka shkenca? Fizika, kirurgjia dhe matematika ç'kanë të bëjnë me hitlerizmin? A egziston vallë një matematikë hitleriane?

Dhe pse i biri i Izraelit i dha botës disa shkëndia për të ndriçuar, është një arësy kjo që bota të shkelmojë atë çpikje dhe atë çpikës?

Gazeta e Korçës, 29-IV-1933

DAMBLLAJA T'U BJERË

«Merre një zemër, puthe dhe rrëmbeje,
Dhe adhuroje si alltar prej feje,
Njëqind Qabera s'vlejnë sa një zemër
Zemër kërko haxhi, jo gur Qabeje.»
Kështu foli poeti persan. Sot mund të flasim
pak më ndryshe; p.sh.:

— Mer një thes misër, puthe dhe rrëmbeje, —
dhe adhuroje si alltar prej feje. Njëqind Qabera
s'vlejnë një thes misër, misër kërko haxhi, jo gur
Qabeje». Kështu e solli devra. Dhe faji s'është i yni.
Bota ka misër sa të hanë qëntë; grurë sa të mbyetet
njerëzia; verë sa të vaditësh lulet; mishra zarzavate,
kafe, sheqer, sa të duash. Dhe me gjithatë ka plot
që ngordhin urie.

Ata që kanë stoket kolosale, i shkatërrojnë, për
të mos rënë çmimi. Dhe shtetet mbajnë sehir. Dhe
pleqtë u thonë të rinjvet: «Juve e prishët botën; se
që kur dolën këto modhat dhe ksemodhat, që kur
humbi kali dhe mushka dhe doli automobili, që kur
filluan të imitojmë Europën, humbëm moralisht dhe
materialisht. Neve qëmoti, s'mendonim kurrë për bu-
kë; këng' e valle. S'dinim shumë gjëra. Dinim q'na
thesh prifti dhe hoxha.».

Pleqtë kanë të drejtë, kur thonë se bota s'është
më të. Por dhe ata gabohen, kur pretendojnë që çdo
i ri duhet të bindet pa ngurim, në gjëra që s'i mbu-

shin mëndjen. Sotjeta është një luft' e vërtetë. Djali, që kur bëhet dhjetë vjeç, fillon të mendojë, dhe s'bindet nga hera në parimet e gabuara të pleqve.

Bota po shkatërrohet ekonomikisht, jo pse të rinjtë dhe gratë vunë kapella, jo pse automobili dhe aeroplani zëvëndësojnë mushkat, por pse sistemi ekonomik i vjetër është krejt i gabuar. Ekonomistët e Europës pranojnë falimentimin e sistemit ekonomik të shkallës liberale. Por ku është krijimi i një tjetri?

Dhe është bela me popujt e urtuar, se s'pret puna. Kur ata kërkojnë misër, diplomatët udhëtojnë. Dhe paratë e udhëtimit e dini kush i paguan? Ti e unë, e tjetri. Tashti janë mbledhur në Amerikë dhe thonë se ja kanë shtruar me birrë. Të shohim dhe këtë herë. Në mos bëfshin gjë... dambllaja t'u bjerë (siç thonë plakat).

Gazeta e Korçës, 4-V-1933

MILLONAJ DHE DHASKALI FILOZOFOJNË

Ishin shtruar këmbë kryq dhe bënин muhabet. Millonaj thosh: «Ka Perëndi». Dhaskali thoshte: «Jo!» Muhabeti ish i qetë. Millonaj dhe dhaskali kishin vendosur ta gjenin vëllezërisht «të drejtën». Pastaj, s'është nevoja të bësh zhurmë, pér të gjetur në ka ose jo Perëndi.

I pari foli millonaj:

— S'është e mundur të mos ketë gjë; c'janë gjithë këto male, fusha, dete, lumenj, njerës dhe kafshë? Kush i krijoj? Këtë natyrë kaqë të bukur, diellin e florinjtë, hënëzën prej ergjëndi, yjet e panumurt.. kush i bëri, veçse një «zanatçi i mbaruar»? Një sahat, që të ndreqet, ka nevojë pér orëndreqës. Bota s'është veçse një sahat. Dhe orëndreqësi është Perëndia. Përse, kur sheh një sahat, je i sigurt që e ka bërë një orëndreqës, dhe kur sodit këtë goxha botë mohon qënien e një ustai?»

Këto tha millonaj dhe duke buzëqeshur, drodhi mustaqet me krenari.

Dhaskalit i erdhi festja rrrotull. Se llogjika e millionajt ish e kthielltë në mos bindëse. Dhe ish turp, që një millona të zinte dhaskalin në fjalë.

C'do të thosh furxhiu, rrojtësi, kryeplaku, kur të hapej fjala, që millonaj di më shumë nga dhaskali? Pastaj, dhaskali, nëpër fshatra konsiderohet si m'i dituri i vëndit. Prandaj dhaskali u ndodh ngushtë;

për ndryshe, millonaj duhej të bëhej dhaskal, dhe dhaskali millona. Një përgjigje millonajt ish e nevojshëme. Drodhi dhe ai mustaqen (për të marrë hakën), buzëqeshi dhe: . . .

— Që thua ti, mor zoti millona — (thua ti, s’theim unë, ja pret fjalën millonaj), — që thua zotrote, unë jam më tepër i bindur që s’ka, se sa që ka Perëndi. S’kam arritur të kupëtoj një Perëndi që dërgoi këto ditë një erë të ftohtë për të tharë grurin e fukarajt. Ç’faj kish gruri i fukarajt? Përse krijoi një botë aq të mërzitur? Është e vërtetë, që çdo sahat duhet të jetë ndrecurr prej orëndreqësit. Por orëndreqësi i vërtetë (sahatçiu) është i biri i babajt dhe i nënës. Orëndreqësin qiellor kush e bëri? Nëqoftëse kërkon të provosh me qënien e botës qënien e Perëndisë, gabohesh, dhe bie në gjynah. Se bota është e keqe. Sahati prej sahatçiuut qiellor është i shkatërruar. D.m.th. sahatçiu është gabuar. Dhe jo vetëm aq. Por është dhe shpirtkeq. Qënia e botës provon më tepër mos-qenien sesa qënien e Perëndisë. Se një zot, duhet të jetë i mirë, dhe i pagabuarshëm. Prandaj nuk bindem. Desha të të përgjigjesha, se nesër pasnesër dalin e thonë grat’ e fshatit, që millonaj di më shumë se dhaskali. Po të më kiske thënë ti, se s’ka Perëndi, unë do të thoshja ka... për të bërë muhabet. Se ndryshe si do ta shkojmë ditën? Pastaj, ka ose s’ka, ç’na duhet neve? Le të lëmë të diturit të prashitin rrëth këtij problemi.

Këto tha dhaskali dhe heshti. Millonaj u vrejt, bëri kryqin (se binte kambana) dhe tha: —

— U prish bota! Shejtani (qoftë larg) hyri në barkun e njeriut.

DRAMË ME TRE AKTE

Kalderoni thotë: — «Jeta éshtë një éndërr; dhe éndërra, éshtë éndërra e një éndërr». — Veç éndërrës, jeta éshtë dhe një dramë. Dhe drama përsëritet ditaditës. Tre janë aktet e dramës: Mëngjezi, Dreka dhe Darka. Gjumi éshtë antr'akti. Ndryshimi i dramës së jetës me dramën e gjenjeshtërt që shfaqet nëpër skena, éshtë i madh. Se në dramën e jetës, dëshërojnë që antr'akti të jetë i gjatë dhe sa të jetë mundur më tepër. Kurse në dramën e skenave antr'akti na mërzit. Dhe tashti një përbledhje të dramës së jetës.

— Kikiku! këndezi i parë. Ngrihet perdja e syve të tu. Férkon sytë, rënkon, ngrihesh e lahes. Vishesh, pi kafenë, thëthit bashkë me 'të një cigar duhan; aktiviteti mendor fillon në çast. Dhe të duket sikur s'ke fjetur fare. Se gjumi s'ësht aspak një pengim në unitetin e ndërgjegjes.

Neise, mbaron toaletën krejt, vesh pallton e madhe, dhe ikën për në punë. S'je larguar edhe një çapë prej shtëpisë, kur të vjen djali i vogël me nxitim, të thërrret... që nga larg... «baba! baba!».

— C'ke mor, plaç të preftë! — se e di që për ndonjë porosi të do.

Dhe djali, i trembur, thotë: «Më tha mamaja, mos harro, të sjellësh mbrëmë kur të vish, kafe, sheqer, miell, oris, vaj, gjalpë, misër dhe sapun...».

— Po litar, do gjë litar jot'ëmë?» i thotë më inat babaj birit të vet.

— Jo, baba, s'më tha gjë për litar, vetëm për sapun më tha dhe për ato të tjerat. — Akti i parë mori fund.

— Filloj fët-fët i dyti. Ku të vejë burri i shkretë? Nga t'ja mbajë? Ka një punë, por ato që merr s'i mjaftojnë as për bukë. Prandaj është kredhur në borç. Dhe dita e tërë shkon, me mendime, me frikë, me dëshpërim. S'është i lirë të vejë kudo. Se i kërkojnë paratë. Dhe ai të këpucët shpirtin. Bëri si bëri, gënjeu një tregëtar, i mori diçka, por porosinë s'e mbaroi!

Dhe prapë, kokë-ulur, me torbën në dorë, kthehet nga erdhi. Dhe gjer sa vete në shtëpi, i dridhet zëmra. Kur arrin te dera e tij, thotë: «shyqyr, shpëtova që s'më pa tagrambledhësi, ose kasapi!» Shyqyr se shpëtoi, por në realitet nuk shpëtoi aspak. Se akti i tretë i dramës filloj me trokitjen e tij te porta e shtëpisë.

Akti i tretë. — Papritur t'u thotë mirëmbërëma, gruaja e pyet në i solli plaçkat e porositura. Kur shikon se kafeja dhe mielli mungojnë, fillon të bërtasë, të mallkojë veten dhe ditën që u martua me një burrë të tillë: «Pika burrit, që s'është i zoti të ushqejë fëmijët e tij! E pe se ç'u kish sjellë sot fqinji gruas dhe fëmijës? Tri shqera, dy thasë miell, këpucë Evropi, rroba stofë angleze... Ja burrë për të qënë!»

— Ke hak, moj motër, — thotë burri i shkretë, — ke hak, por hakën e merr millonaj. Se mikut tim, fqinjit, i piell dhe këndezi, kurse mua s'më piell as pula. Atij i la babaj; mua babaj më la vetëm një kësolle për dhi, një mushkë qorre, dhe një jatagan.

Fillojnë hanë bukë, dhe kur mbarojnë, ikin bu-

rrri në odën e vet, dhe gruaja në të sajnë. Tamam si motër e vëlla. Është fundi i aktit të tretë.

Tragjike, shumë tragjike monotonja e jetës. Nga-hera luhet po ajo dramë, gjer në fund... kur vdesin aktorët.

Gazeta e Korçës, 6-V-1933

KUR RRUKULLISET DOLLARI

«Njëra gozhdë shtyn tjetrën» thotë proverbi. Kështu ngjet edhe në politikë.

Kur erdhi Mac Donaldi në Romë, tërë bota flisin për «Direktorin» e të katërve. Pastaj filloi Hitleri dhe «antisemitisma» e tij. Sot tërë bota i ka mbërthyer sytë në Amerikë. Dollari u rrukullis. Në një mënyrë të qetë, po të sigurtë, Amerika hoqi dorë nga baza-flori. Është një çështje që intereson botën an'emb'anë.

«Xha Sami», krenar për monedhën e tij të «patundëshme», sot ul sytë dhe s'flet, po vepron. Pse ra dollari vallë? Si ngjau ky taksirat? Ç'rrjedhje do të ketë? Dhe pse Rosvelti s'priti që delegatët frengj dhe anglezë, të arrinin njëherë në Amerikë, pastaj ta bënte «proçkën kollosale»?

Po të pyeç thellë-thellë, këto gjëra janë mistere, që vetëm Amerika mund t'i kuptojë. Se Amerika kish dhe ka flori, sa të notosh në të. Me gjithatë e rrëzoi dollarin. Dhe është e kënaqur.

Duan të thonë se rënëja e dollarit është një grusht kundra Angliterës, që rrëzoi sterlinën. S'është çudi. Se mallrat angleze, me rënien e stërlinës, u bënin një konkurencë të fortë atyre të Amerikës. Mirë po (se ka një «po»), ç'taksirat ata të shkretë që kishin nëpër dyqanet ose nëpër banka, ato pak ekonomira të nxjerra me djersën e ballit?

Sidoqoftë, rënia e dollarit provon, se paraja amerikane s'është me të vërtetë parajsë. S'di njeriu ku t'i verë paratë. Bankat falimentojnë pa rreshtur, trumbullira ekonomike, është m'e rrezikshme, shumë m'e rrezikshëme nga trumbullira politike. Zati, e para është nëna e së dytës. Prandaj lum ata që s'kanë!

«Konferenca ekonomike e përbotëshme» pas pak javësh do të na tregojë në kanë mbetur vërtet burra për të rregulluar botën ose jo.

Jemi në çastin më kritik të historisë; dhe shumë s'duan ta kuptojnë.

Ose konferenca ekonomike do të japë përfundime konkrete, ose vullkani që po zjen do të pëlcasë.

Gazeta e Korçës, 12-V-1933

ZBRITJE E RROGAVE

Nevoja na imponon sakrifica. Buxheti ynë s'mund tē bëjë përjashtime nga buxhetet e shteteve tē tjera. Është sémurë. Vuan nga hemoragjia. I është hapur një vrimë. Dhe ajo vrimë duhet vulosur. Që tē vuloset duhen sakrifica. Dhe sakrifica e parë, janë dhe duhet tē jenë rrogat e majme. Paralelisht me zbritjen e rrogave, duhet zbritur (në mos me hir, me pahir) dhejeta e shtrenjtë.

Po le tē meremi vesh më parë, që tē mos kemi llafe pastaj. Kur them duhen zbritur rrogat, nuk kuptojoj me këtë gjë zbritjen e rrogës, as atë tē portierit tē parlamentit, tē fshirësit tē ministrave, tē protokollistikit tē nënprefekturave, ose tē mësuesit.

Ka se ku tē priten rrogat; sa sekretarë, kryesekretarë, mbikryesekretarë dhe nënë kryesekretarë, sa shefë, mbishefë dhe nën shefë, sa kontrollorë mbi kontrollorë dhe nënkontrollorë, sa e sa, marrin më tepër nga ç'duhet, nga ç'meritojnë. S'fola për baballarët. Baballarët e kuptojnë vetë. Ata na kanë në dorë. Por më poshtë do tē flasim për ta.

Që rrogat do tē zbriten, është e sigurtë. Ajo që s'dihet, është se kush do ta pijë pas kurrizit. Prandaj nëpunësit e vegjël u thonë baballarëvet:

«Kini mëndjen, or allajseversën, mos na merni më qafë!»

Por është edhe një problem tjetër. Si do tē guxojnë baballarët tē vrasin veten me duart e tyre?

Se po t'i besojmë gazetës «Vatra», një deputet, pas një mundimi tremujor, paska bërë hesap, se në katër vjet e sipër, do të ketë më njanë disa qindra napolona me këndes.

Me zbritjen e rrogavet, hesapi ndryshon. dhe deputeti duhet të fillojë prapë nga alfa, domethënë i shtohet tre muaj punë.

Dhe këtë gjë s'ja ka borç babaj fisnik, as parlamentit, as të nënëshkruarit, as «Vatrës».

Gazeta e Korçës, 16-V-1933

POLITIKË POPULLORE

Si qëndron puna? Ku ka ngelur? Kemi apo jo luftë? Këto pyesin ditaditës ata që s'dinë të lexojnë në asnje gjuhë të huaj. Dhe kur nuk u jep dot përgjigje, të thonë me përbuzje: «jazëk shkolla që të nxori!» Dhe ikën fshatari i çakërdisur, i pakënaqur, pa shpresë. Të themi të drejtën, dhe ata që lexojnë dhe ata që s'lexojnë me një shkallë janë. Bile shumë herë ata që lexojnë më tepër nga ç'duhet, trumbullohen dhe i harrojnë të gjitha. Punët e Europës, janë si me magji. As djalli s'i merr vesh. Kur pret një gjë, hop të del e kundërtë.

Puna, mor evlat, ka mbetur e varur mbi një pëtë kalbur. Të mëdhenjtë kanë pretendimin të pajtijnë të vegjëlit kur rriven. Lidhja e Kombeve u bë Muze, ku, shpejt a vonë, do të venë turista, për të admiruar antikitetet madhështore të një kohe plot lavdi.

Udhëtimet diplomatike po dëndësohen. Një provë që s'kemi gjë në torbë. Herrioti vajti në Amerikë me shtatë dollare në xhep; dhe u bëri amerikanëve poezi. Amerikani dhe poezia janë dy pole me të njëjtin emër. Dhe i kërkoi Herriotit paratë. Herrioti shkundi tymin e pipës dhe të xhepave.

Thonë se Hitleri do të vejë në Gjenevë të pigmat me Daladien; është njëlloj sikur të thonë që ujkun do të lidhë traktat me qenin.

Roosvelti i ka zët udhëtimet. Ka frikë se e zë vaponi; prandaj, me anën e radios, dërgon oksigjenin e tij në Europë. «Kondit' e parë që të mbledhësh vehten», i thotë Roosvelti Europës, «është të më paguash mua borxhin. Ti Francë, s'duhet t'i kërkosh Gjermanisë paratë; por mos harrro që shkuan katër muaj dhe Amerikës s'i ke paguar këstin». Franca u përtyp, ashtu si ai njeriu që piu uthull kur e pandehte si verë. Mesazhi i amerikanëve ishte i thartë.

Kemi dhe konferencë ekonomike të përbotëshme. Është shpresa e fundit për stabilizimin e perëndimit krenar dhe egoist. Ose bota do të kredhet në anarkinë ekonomike, politike dhe sociale më të tmershme, ose timonierët përgjegjës dhe tragjikë të popujve do të hedhin poshtë maskën e fëlliqur të hipokrizisë, për të shikuar problemat sy-për-sy. Një nga të dyja.

Dita 12 qershor do të na tregojë shumë gjëra. Le të presim...

Gazeta e Korçës, 9-VI-1933

DY ADHURONJËS TË JAPONIT

Mehdi Frashëri i jep popullit shqiptar, si shtet model për të imituar, Japonin; më duket se modeli s'është i goditur. Një nacionalizmë mystike, fetare, një shovinizmë që ka rrënjet në errësirat e shekujve; e përzierë pa proporcion me oksidentalizmën më të përparuar, s'është ajo që na duhet sot për sot. Japoni s'është aspak një shtet model për t'u treguar si shembull. Ka mjaft shtete në Europë; përsë të udhëto tojmë gjer në lindjen e largme?

Me këtë rast dy fjalë për një adhurues tjetër të Japonit; dua të them për Z. Paul Sofi, shqiptar që dërgon përshtypjet e tij në një nga gazetat e kryeqytetit. Pauli në fjalë e ka gjetur Japoninë shumë poetike. Dhe mund të jetë vërtetë «Vendi i lulevet, vendi i të gjithë bukurive», siç e quan Paul Sofi me entuziazmin e një poeti. Po s'flet Paul Sofi për një lloj poezie tjetër, për poezinë e luftës. Vaporrët kolosalë, që vjellin tym të zi dhe barut helmonjës; aeroplanët gjigandë, që korrin e përvëlojnë të fajshmin e të pafajshmin; bajonetat shkëlqyese prej gjakut kinez; a nuk janë dhe këto «bukurira të Japonit», që kanë poezin' e tyre? Kush vete në Japon dhe nuk ve re këto gjëra, ose është i dehur prej «luleve të Japonit», ose gënjen. Dhe Zoti në një nga të dhjetë këshillat, thotë: «Mos gënje!»

Gazeta e Korçës, 3-VI-1933

POKER MË KATËRSH (¹)

Një sallë e madhe e bukur, por e kredhur në një atmosferë shqetësie dhe pasigurimi. Katër burra të mëdhenj bisedonin koka më kokë diçka me rëndësi. Salla quhej Europë; dhe burrat që bisedonin koka më kokë diçka me rëndësi, ishin timonierët e saj.

— «A nuk bëjmë një poker më katersh? — tha italiani papandehur, — koha është e vrejtur, s'ke ku shëtit në këtë kiomet; e ku të vec? Amerika na ngopi me mesazhe; Lindja na shurdhoj me topa».

— Mirë e ke menduar, — i thanë tre të tjera; — ku djall t'u kujtua?

Dhe nga gazi i madh po përpinqnin kokat nëpër mure. Hidhet dhe thotë Hitleri:

— Unë do të los veresie, se s'më ndodhen sot për sot të thyera në xhep.

— Veresie s'ka, — tha Franca, me gojën e Boncourit. — Paratë në dorë ose rri e mbaj sehir; jemi ngopur me veresiet e tua.

Nejse, bënë si bënë, e rregulluan që ingjilizi të bëhej qefil për Hitlerin, i cili lonte «tapis»²) pa filluar lodra. Dhe filluan të ndanin letrat... Kur... një burrë i dëgjuar hyn duke qarë, vete pushton Boncourin dhe i thotë:

1) — Ishte koha kur po nënëshkruhej pakti i të katërve.

2) Termë teknike e pokerit që don të thotë të lozish pa lekë në xhep.

— Shiko se do të gënjejnë, dhe pastaj ku të futem unë, djali yt, që do të mbetem si dhija në mes të ujqëve?

— Ky burrë ish përfaqësues i Antantës së Vogël⁽¹⁾, që emrin ja thonë Benes.⁽²⁾

— Pusho, — tha Boncour, — se ty s'të lë kurrë vetëm unë. Ta dish që pokeri do të kish mbaruar me kohë po të mos kisha menduar për ty, moj bija ime e vogël... Antantë.

Englez shikon, dhe me gjakëftohtësinë legjendare thotë:

— Léri çiliminjtë o derëzi Boncour! Se me ata s'bisedon veç se çilimillëke.

— Jo, — ja pret Boncour, — s'janë çilimij aspak; a nuk e mban mënd më '14-të që lojtën si burravalle?

Kur dëgjoi Hitleri emrin e luftës së '14-tës mori dhe përplasi letrat me inat, ktheu bangon përmbysh dhe tha:

— Në u mblodhmë këtu për të biseduar gjëra të tilla, unë ikëj. Dhe po të doni, në ua mban, loni më trish...

More kujt i thërret ashtu, si arixhiu së shoqes? — i thotë Franca Gjermanisë. — S'ta ka njeri frikën.

Një zë i rëndë, që dolli prej italianit, i bëri të pushojnë që të dy. Anglezi tha: «Yes, duhet filluar». Dhe filloi... Hitleri kish në dorë një «karré asso»⁽³⁾, dhe i thotë Boncourit: «Restë!».

— S'lohet me këtë, — tha Boncour. Ky për të humbur s'humbet gjë, dhe në fitoftë na i mori të gjitha...

Gazeta e Korçës, 16-VI-1933

1) Lidhje shtetesh në mbrojtjen e Francës.

2) Burrë shteti çek.

3) Letër e fortë në poker.

GJASHTËDHJETË E GJASHTË

Gjashtëdhjetë e gjashtë janë burrat e shtetevet që kanë vendosur ta nxjerrin botën në selamet. Dua tē flas pér konferencën ekonomike të përbotëshme. Pse jo? Gjithë bota flasin. S'ka arësy që ne të heshtim. Po le tē kthehem i në numrin 66. Asëll, asëll, ç'do me thënë 66? Mund tē thotë dikush. — S'është pyetje kjo, mor zotni! — Atij «Dikushit» teveqel i themi:

— Është pyetje dhe me vrap! Dhe ja ç'kuptim ka numuri 66. Dëgjo, dhe mos folë, mbylle të shkretën, se mban erë... hudhra. 66 domethënë 66 bombé, që zbukurojnë 66 koka diplomatësh, domethënë 66 smokinga, 66 bastunë, 66 fjalime të gjata (korçarët marrin vesh mirë çdo me thënë fjalim i gjatë në vapë... ouff!)

Mëndja e përbotëshme ndahet në gjashtëdhjetë e gjashtë pjesë të ndryshme; do tē kemi në konferencën ekonomike të përbotëshme gjashtëdhjetë e gjashtë plane të ndryshme. Gjashtëdhjetë e gjashtë koka plot (gjer në majë) me tru, do tē çfaqin gjashtëdhjetë e gjashtë projekte të ndryshme. Dhe përfundimi duhet tē jetë, që gjashtëdhjetë e gjashtë kokat duhet tē sintetizohen më «Një dhe tē pandarë», simbas unjillit. Gjithëkush do tē mbrojë projektin e vet.... Dhe do ta lavdërojë si arixiu shoshën. S'di në do tē kërcasë ose jo druri, shkelmi a boksi, midis

gjashtëdhjetë e gjashtë myteberëve. Sidoqoftë, më në fund do të nënshkruajnë një traktat që do të pagëzohet traktati i Londrës. Traktati në fjalë do të përmbajë gjashtëdhjetë e gjashtë mendime të ndryshme; me pak fjalë «çorbë derri». Dhe pastaj do të dalë ndonjë Kajzer i dytë dhe do të thotë: «Pash zonë, ç'e kini këtë paçavure?» Dhe paçavuria do të përvëlohet, dhe përsëri gjashtëdhjetë e gjashtë burra do të mblidhen dhe do të bëjnë një tjetër traktat, pér ta përvëluar pas pak kohe.

Historia përsëritet. Dhe njerëzit nuk nxënë mënd. Fajin e ka jorgani mitologjik i Nastradinit. Nukë? Se puna e konferencave dhe e traktateve është pikërisht si ajo e jorganit të Nastradinit. Kur dy veta rriheshin përjashta shtëpisë së Nastradinit, Nastradini del me jorgan në kokë që t'i ndante; ata ja muarën jorganin; ç'faj kish jorgani?

Kur diplomatët s'merren vesh, s'ndreqin dot maqinën ekonomike, popujt e mbajnë barkun me dorë; s'është një arësy. Popujt dhe jorgani janë viktima.

Gazeta e Korçës, 27-VI-1933

NALTMADHÉRIA E TIJ FINANCA

Pa pasur frikë përgënjeshtrimi, mund të themi se shtetet e vogla (ata më prapanikët nga pikpamja kulturale dhe shkencore) janë pikërisht ata kù korruzioni është më i paktë. Se në të vjedhtë tjetri paratë, t'i vjedh me përdhuni, me forcë, me mundim. Dhe kur e zenë hajdutin, ai thotë: — T'i vodha, — dhe e dënojnë. Po ç't'i bësh hajdutit të qytetëruar, me gravatë të mëndafshtë, me bombé, që emrin vërvetes ja ngjit bankier, ose shoqëri anonime, dhe t'i merr paratë pa t'i kthyer përséri?

— «Skandal»! Thonë gazetat e Europës, kur rrulliset një shoqëri, një bankë, dhe skandali, tërheq në rruckullimën e tij mijra familje që kishin depozitar atje ato pak para. Ne të paqytetëruar, preforjmë t'i mbajmë (kur i kemi), në dollap. Dhe s'bëjmë keq.

Historia e skandaleve financiare s'është aspak një çpikje e re. Që nga shekulli i shkuar, «Skandali i Panamasë» helmoi dhe shkatérroi vatratë lumtura.

Po le të mos largohemi shumë. Mjaftojnë këta dy tre vjetët e fundit për të mbushur një libër me skandale. Më 1929, Wall-stret, dha kushtimin; lart nga shtatë persona ja hoqën vetes; mijra njerëz që kishin fjetur miljonerë, u gdhinë pa bukë. Skandali i Wall-stret-it, përhapi panikun në popujt e qytetëruar.

Dhe pastaj plasi në Francë skandali «Oustrik». Personalitete të shqar u akuzuan... Dhe duallën të pafajshëm. Këto ditë edhe bankieri Oustrik doli i pafajshëm. Skandali Oustrik ish lidhur ngushtë me skandalin — «Snia-Viskoza». Dhe që të dy, si Oustriku edhe Gualino, mbyllën dyert, muarën në qafë botën, megjithse kishin gravatë.

Po ai që mban rekordin e skandaleve, është ai i bankës kollosale «Morgan». Habitet bota, kur sheh se në listën e këshilltarëve të asaj banke figurojnë personalitete që kanë fatin e popujve në dorë.

Financa qeveris, financa udhëheq, financa firmon paqë, shpall luftra, përpilon ligje, ngreh dhe shtie qeverira, emëron ministra; dhe financa vepron nënë dhe. Asnjeri s'e merr vesh. Asnjeri s'e provon dot. Me gjithatë, ashtu është. Roosvelti, presidenti simpatik dhe kurajos, vendosi ta kthjellojë një atmosferë të tillë. Vendosi t'u shpallë luftë spekullatorëve dhe hajdutëve me gravatë. Do ta kapërxejë dot vallë korentin e fortë? Apo do të tërhiqet prej valëve të tij të tërbuara?

Gazeta e Korçës, 28-VI-1933

SHOQËRI ANONIME

Kur ke ndërmënd t'i japësh një shkelm tjetrit, bujaria më elementare e do që ta lajmërosh. Shoqëria Singjer vepron ndryshe. Jep më parë shkelmin, pastaj lajmëron. Shoqëria Singjer s'është as bujare, as lajmëtare.

Në ka njeri që mund të justifikojë shoqërinë Singjer, për shkelmet e pamëshirta kundra vajzave të vobegta, ai njeri nuk jam unë.

Shoqëria Singjer ka vendosur të qepë gjithë rrobat e grisura të shqiptarëve me maqinat e saj; s'është kjo një arësy që me shkelmet e saj, t'i shqepë ato rroba që qepi. Atëhere ç'u kupëtua? Por shoqëria Singjer ka edhe ortakë.

Sesa ¹⁾, ka vendosur ta bëjë natën ditë me anën e elektrikut. Shumë mirë. Por godit shumë herë që drita e elektrikut është aq e fortë, sa të qorron sytë, (dhe të boshatis xhepin); se kur njeriu qorrohet, është kollaj t'i shkundësh xhepin.

Sita ⁽²⁾, që ka vendosur të kripë me kripën e saj të kripur gjithë kombin, del dhe ajo nga ndonjë herë nga rruga e drejtë. Ka vende ku kripa është shumë e kripur dhe e fortë.

Agipi ⁽³⁾, sikur të vendos, në një çast marrëzie, të djeg shtëpinë me benzinë, ju betohem që nuk do të ble nga ajo e Agipit, se nuk ndizet.

Sa herë që më shket këmba nëpër kalldrëmet e

Tiranës, sa herë lluca ngjitet dhe zbukuron këpucët e pantallonat, mallkoj Skajën⁽⁴⁾). Dhe s'jam i vetmi.

S'them gjë për merumen «Dele»⁽⁵⁾. Se njerinë (ose shoqérinë), shaje sa është gjallë. S'është aspak e arësyeshme të themi diçka pér mehrumen... duke qenë se aksionet e saj zbukurojnë dhe do të zbukurojnë për shumë kohë hambaret bosh të aksionistëve.

Ka dhe shumë të tjera: «Beça & Kassigna»⁽⁶⁾ në Elbasan, vjen shumë herë në mosmarrëveshje me hallexhijtë që japid gjakun e tyre, djersën e ballit, për një copë bukë, dhe atë copë bukë s'e marrin në rregull. Djersa e punëtorit shqiptar vlen të shpërblehet ashtu siç duhet sidomos në tokën shqiptare.

Dhe nëqoftëse shoqëria anonime, nënë pretek-stin se janë «anonime», ja hedhin përgjegjësinë Anonimit (që s'është askush), qeveria ka të drejtë të thotë se dhe ajo në këtë rast është anonime.

Se s'ka njeri në botë të quhet «shtet», ashtu si nuk ka «anonim».

Atëherë anonim kundra anonimi. Shteti del fitues!

Gazeta e Korçës, 29-VI-1933

-
- 1) Sesa — shoqëri anonime për monopolin e dritës.
 - 2) Sita — shoqëri që kish monopolin e kripës.
 - 3) Agipi — shoqëri e huaj që kish monopolin e vajgurit që shfrytëzonte naftën.
 - 4) Skaja — shoqëri e huaj për ndërtimin e rrugëvet.
 - 5) Dele — shoqëri anonime për blektori që s'pati jetë të gjatë.
 - 6) Beça-Kassigna — shoqëri e huaj me ortakë shqiptarë për ndërtimë të ndryshme.

D Y B O T È

Me fytyrën e saj të venitur sillet e vetme nëpër rrugët e errëta. S'ka ngrënë qysh prej tri ditësh. Kërkon bukë, po askush s'i jep. Kërkon strehë, po nga çdo anë shkelmohet. Një qen që vuani, mund ta zbusë zemrën e njeriut, po një vajzë fytyrë lejmone, jo! Faqet e saj të zbeta shkëlqenin në errësirën e natës. Ngjyra e urisë kish zënë vendin e ngjyrës së trendafilat.

Zgjat kokën brënda një dritareje, sheh fëmijët e një të pasuri që këndojnë.

Dy botë në kundërshtim. Njera përbrenda dritares, e lumtur, e qeshur, e qetë, e pasur, besnikë te Zoti. Tjetra përjashtë dritares, e rrahuur prej urisë, prej mjerimit dhe prej dëshpërimit. Veç fu-karallékut s'ka tjetër Perëndi në këtë botë për varfanjaken. Nuk beson te Zoti se s'ka arsyë të besojë. Blasfemon⁽¹⁾ se ka arsyë të blasfemojë. Qumështi që i dha nëna ish i hidhur si vreri. Urata që i dha fetari kur e pagëzoi, ishte mallkim.

Ecën e menduar plot frikë në rrugën e ngushtë. Një dritë përçan errësirën. Vajzës i bie vilani. I duket sikur dikush i pëshpërit në vesh: «Përse e ke humbur besimin te Zoti! Ku banon? Ku e ke atin, nënën?»

Vajza për një çast hapi sytë dhe murmuriti:

1) Shan gjërat e shenjta.

— S'kam asnë shok në këtë botë përveç urisë.
Të gjithë më kanë vdekur. —

Dhe u duk sikur plaku i rrëmbeu engjëllit shpirtin.
Bora kish mbuluar flokët e saj të dendur. Trupi
i ngriu.

Në buzët e saja fjala u r i , ish këputur në mes.

1934

VARRIM NË HESHTJE

Kur vdes një bilbil kambanat nuk tingëlloj-në, as hoxha nuk i lutet Zotit nga maja e minares. Nuk i del as emri në shtyllat e telefonit, as gazetat nuk e zënë në gojë.

* * *

Ditë maji. Rrija pranë drifores. Karshi meje një bahçe plot me lule. Dhe në atë bahçe plot me lule, një bilbil bandill ja thosh këngës. Natyra që e rre-thonte e heshti zhurmën e saja. Era pushoi. Një përrua që rriddhete aty pranë, e zbuti shushurimën e tij. Dhe fëllëza e heshti këngën. As fletët e pemëve nuk lëkundeshin më.

Lulet, që të gjitha, kishin hapur burbuqet e tyre dhe i buzëqeshnin bilbilit sevdalli. Ndoshta kishin rënë në dashuri me 'të.

Përmes kësaj harmonije të kurdisur të natyrës, vetëm unë pranë drifores qëndroja si një notë e çkurdisur. Soditja në heshtje atë mrekulli të pabesueshme. Ëndërritja me sy hapur. Për disa minuta jetova botën e ëndërrës dhe të lumturisë.

Kur... pa pritur pa pandehur... bilibili vdiq. Ra nga maja e mollës dhe gjiri i luleve e thëthiti. Vdiq me këngë në gojë. E vrap ndofta lumturia.

I lumtur bilbil! Kush prej jush ka parë bilbil

të vdesë? Cili njeri ka mbyllur sytë me këngë në gojë?

Manushaqja lotoi. Zambaku psherëtiti. Borzilokun e pushtoi një mallëngjim. Dhe flladi nisi të freskojë trupin e tij. Asnjë klithmë! Varrimi u bë pa zhurmë. Disa pika vesë shiu ishin lotët që derdhi natyra për vdekjen e bilbilit. Pastaj heshti dhe ajo.

I lumtur bilbil! Ç'varrim të bukur pate!

1934

KËNDEZI, PULA APO VEZA?

Sot kemi një muhabet serios. Do të hyjmë pak si në të thella, po mos u trëmbni, se për së shpejti do të dalim.

Duam të dimë se kush erdhi më parë në botë: këndezi, pula apo veza? Mos pandehni se është aq e lehtë zgjidhja e këtij problemi. Megjithatë, unë, me ndihmën tuaj, do të përpinqem ta zgjidh. Në kohët më të vjetra, thotë legjenda, këndezi u martua me pulën, pula nxori vezën. Nga veza duallën pula dhe këndeza. Kështu që më së fundi hesapet u ngaterruan dhe u bënë çorbë. Mendja njerëzore e humbi toruan.

Pula doli më parë apo veza? Le ta marrim problemin shtruar, vënçe, dhe le të thellohem duke pirë duhan.

E zëmë se pula nxori vezën. Po pulën kush e bëri? Nuk besoj ta pjellë këndezi, se pastaj del pyetja: — Kush djall e bëri këndezin? —

Tashti le ta zemë se pula doli nga veza. Po vezën kush e bëri? S'besoj ta ketë bërë këndezi, se të gjithë e dimë që këndezi s'pjell vezë. E po atëhere ç'bëhet? Si djall filloj kjo punë?

Vetëm një shpiegim na mbetet, po dhe ai është pakëz si i errët. Thonë plakat, dhe jo vetëm plakat, se në ato kohë kur Zoti u zemërua kundra Evës, se hëngri fruta «nga Molla e ndaluar», i dha një shkelmë dhe e hodhi në tokë.

Mirëpo, siç dihet, Perëndia është shpirtmirë dhe s'kish qejf që Eva të vdiste rrugës nga uria. Prandaj, meqënëse udhëtimi i Evës do të ish i gjatë, Perëndia i dha një shportë me vezë që t'i hante rrugës. Të gjithë e dimë se sa i gjatë dhe i tmershëm është inati i gruas. Eva, si grua që ish, nga inati, nuk i hëngri vezët që i dha Zoti. Kur po zbriste nga qielli në tokë, rrezet e diellit i ngrohën vezët e shportës. Kështu që, kur Eva vuri në tokë këmbën e mëngjér (se botë filloj së prapi) shporta e ngrohur nga rrezet e diellit ishte mbushur plot me pula dhe këndeza.

Këtë shpiegim shkencor i jepin plakat problemit të koklavitur të vezës, të pulës dhe të këndezit.

1934

VITIN E PARË TË JETËS

Eshtë një zakon në disa vende të Shqipërisë, që cdo njeri, kur bëhet motak, cakton vetë fatin e tij. Dhe ja si ngjet kjo punë: e marrin foshnjën motake, e vënë përpëra një tryeze mbi të cilën ka lloj-lloj gjërash simbolike, si bie fjala flori, pena, kobure, kazma, libra etj. Në rast se foshnja kap me dorë florinjtë, prindërit thonë: «ky djalë do jetë gjithmonë i pasur». Në rast se djali kap librin, djali del filozof. Dhe kështu caktohet karriera e cdo njeriu prej vitit Një të jetës së tij. Dhe kështu spjegohet ndryshimi i njerëzve në zhvillimin e aktivitetit të tyre.

Ai që sot është ministër, kur ka qenë motak, sigrisht ka kapur me dorën e djathjtë kulltukun mbi të cilin rri. Kush është deputet, ka hedhur dorë, ose më mirë (gishtin e dytë të dorës së djathjtë) në zemër dhe në ndërgjegje; prandaj deputetët punojnë pa rreshtur dit'e natë pér këtë vend.

Ai që sot di pesë para gram, ka cikur me dorë penën; prindërit e tij kanë thënë: «Ky djalë do të bëhet shumë i ditur», dhe djali i tyre u bë dhaskal; se s'është konditë që, pér t'u bërë njeri i lartë, duhet të jeshë i ditur.

Ka njerës që në vitin e parë të jetës së tyre kanë cikur koburen dhe janë bërë më vonë rojtës, oficera ose pensionista veteranë. Ka që dorën e kanë

hedhur mbi qarkore; këta më vonë janë bërë protokollista, viktima të pamëshirëshme të çdo shkrese zyrtare.

Dhe ata që kanë ngritur dorën e tyre përpjetë, pa cikur asgjë, janë bërë priftërinj, hoxhallarë ose hahamë, duke pasur lidhje vetëm me atë atje sipër... se bota këtu poshtë nuk u intereson aspak; dhe po t'ish e mundur do të ushqeheshin vetëm me frymën e shenjtë. Por iku ajo kohë kur Krishti ushqente pesë mijë veta me pesë cirojka dhe dy karvele bukë. Njerëzit që kanë hedhur dorën mbiëmbësirën janë bërë sheqerxhinj, ata që kanë kapur shishen e rakisë janë bërë pijanecë.

Sa për ata që, qysh në motin e parë kanë kapur letrat e bixhozit, në do t'i gjesh ku janë shko në Tiranë, futu në kafe të madhe dhe do t'i shikosh duke lojtur poker, ose duke vrarë miza, mbassi i humbën të gjitha... Sa për veten time s'e mbaj mënd, por siç më kanë thënë, kur më vunë përpara tryezës magjike, kapa me dy duar fytyrën e atit tonë që është në qiell, e putha, e kafshova (si çilimi që isha) dhe pastaj e putha përsëri. Gjithë sa qenë aty thanë:

— Ky do të bëhet dhespot i dëgjuar. — Kurse unë s'u bëra gjë gjer sot... Por si thotë proverbi: «Kemi kohë, më mirë vonë se kurrë.»

Revista Jeta dhe Kultura, 10 korrik 1935

GJYSMË ORE JO SHQIPTAR

Vendosa të bëhem gjysmë ore italian. Do të xhvishem krejt nga ndjenjat shqipëtare; bile nuk e njoh fare Shqipërinë. Do të ndryshohem për gjysmë ore dhe do të bëhem një nga ata italianë të cilët s'kanë as më të voglën ide për Shqipërinë; të cilët s'merren me politikë; nuk dinë veçse të lëvrojnë arat e tyre.

Një ditë dikush vjen e më pëshpërit në vesh fjalën «Albania». ¹⁾

— Che cosa è? ²⁾ — i thom mikut. Por ai s'më përgjigjet. Dhe unë, për kuriozitet, hap «*Nuovissima Encyclopædia Italiana, Milano, 1936, II edizione.*»

Tamam! Kush më mirë se Enciklopedia do të më japë një ide të qartë mbi fjalën «Albania»? Dhe hap në faqen 57; e gjeta fjalën që kërkoja. Dhe ja ç'lejox:

«Albania: krahinë turke!... prodhon verë, mjaltë, krimba mëndafshi!... Flitet gjuhë Frigje (!?), o Greko-Latine. Raca, klima, besimet, të përziera. Natyrë kryengritëse për Ballkanin, shkëndi frike për Evropën!»

1) Është për t'u habitur se edhe sot e kësaj dite ka burra shtetesh që djathtas e majtas marin borxh nga arsenali fashist i 1936-tës për të denigruar popullin tonë.

2) Ç'është kjo?

Ka dhe xhevahire të tjera, por këto janë nga më të çmuarat. Tashti unë, si italian i paditur, mora një ide mbi Shqipërinë; dhe q'ide!

Pas pak, një ditë befas lexova në fletore se Italia ka lidhur një traktat miqësie me Albanian (krahinë turke); si? jemi aleatë me shtetin që është gati t'i verë flakën Evropës?

Dhe e humba torruan... U shkunda, u lëkunda, erdha ndërmënd, u bëra shqiptar.

Dhe si i tillë flas tashti: Enciklopedia italiane e vitit 1936, meriton një vend — klasë nderi — në muzeun e Milanos. Erudit që hartoij fjalën «Albania», ka nevojë për mësimin e parë të shkollës filllore. Se kur shkruan diçka mbi këtë tokë, duke pasur trutë mbi hënë, është më mirë ta thyejë, ta bëjë copë copë atë qerrata penë, se nuk e ka zanat; le të zerë një zanat tjetër, por jo redaktori i enciklopedisë më të madhe të Italisë.

Redaktori i enciklopedisë le të bëhet bojaxhi, se edhe atje më penë do të punojë; por të paktën le të fëlliqë muret por jo sedrën e tërë një shteti, qoftë edhe i vogël.

Një nga të metat ose cilësitë (quaji si të duash) tona, është gjaknxehtësia, kur goditemi në nder. Sidomos kur kritikat vijnë nga çpifje, nga mërirë ose nga injoranca.

Dikur një erudit sërb dolli përpara botës letrare dhe tha se shqiptarët kanë bisht; natyrisht historiani i famshëm, nuk besoj të ketë fituar çmimin e historisë me atë libër. Sot në shekullin XX, 1936, eruditë milanez, del e thotë se s'kemi gjuhë, s'kemi kombësi, se jemi krahinë turke. Mashallah! Jo, xhanëm!

Po sikur ne, nesër të nxirnim një enciklopedi dhe të përsërisnim për shtetin italian po ato përqartje t'eruditit milanez, ç'bëhej atëhere? Lesh e li.

Por jo! Injoranca e një të çmenduri nuk angazhon aspak kulturën dhe erudicionin latin. Por trandafili rrallë e tek nxjerr ferra, dhe kur i nxjerr janë nga ato më të egrat, më të këqijat, më të tħrezz-këshmet; duhet t'u vesh flakën pér t'i ċdukur. Por fakti eshtë se trendafili më i bukur, më i kändshém, nxjerr ferra; dhe ferrat rriten e zgjaten, sa prishin, ose përpiqen të shkattrojnë vreshtin e fqinjiet. Italia e 1936-tës ka ferra të tilla. Dhe këto ferra jetojnë dyzet vjet pas nga bota; janë anakronike, pra tē padobishme, (pérse mund tē shérbejé si gjë tjeter ferra veçse si ushqim pér gomarin?!), pra duhet ćkulur dhe duhet ruajtur nē muzetë humoristike tē shekullit XX, nē ekzistojnë muze tē tilla.

Gazeta Arbëria, 3 korrik 1936

— Gjyqet e përgjigjet që mësuarin e këtij vjeti është as njerifët që
Gjyqet pëllë doqët mësohet këtij mësuarin e këtij vjeti është as njerifët që
mësuarin e këtij vjeti është as njerifët që mësohet këtij mësuarin e këtij vjeti
— Gjyqet doktor... Përse qëndritur? Në
Diku në botë.

1881

ROMANTIKA E URISË.

«Përse të vij vërdallë duke shëtitur derë më derë fukarallëkun dhe urinë?

«Përse t'u lutem atyre që kanë më tepër mëshirë për një qen se për një liparak?

Këto thosh me vete një vajzë që fataliteti shqëror e kish shkelmuar. Dhe vajti në spital, fali gratis trupin e saj te operatorët për eksperiencia shkencore. Dhe shkenca është indiferente për një trup njeriu më pak ose më shumë; mjaftron që të përparojë.

E shtrirë mbi një mermer, e patrëmbur, tha filizi i njomë, para se thika t'i çante zorrët:

— Doktor, çaje trupin tim, nxiri zorët pa frikë, pa kujdes për mua. Ngule thellë thikën doktor, në zemër, në shpirt..... dhe do të zbulosh atje «dhembjen e hidhur të urisë. Foli zëmrës sime, kur ta çposh, dhe pyete:

— A ke vojtur? A ke qënë e brengosur? Përse je reshkur?» dhe do të njohësh prej saj misterin e urisë dhe të vdekjes.

— Coptoji doktor këto mishra, që s'i trazoi mashkull me dorë.

— Shiko ç'flokë... të zes, të derdhur, të dëndur, të gjatë, shiko si shkëlqejnë! Të paputhur doktor, të papërkëdhelur, do të hyjnë në gjirin e ftohtë të dheut.

— Shiko ç'buzë, që nuk shijuani as një të puthur! Çaji, bëji copë; mos ki mëshirë as për syt e mi të mëdhenj, që s'janë vëçse errësirë dhe mjerim.

— Shpejt, doktor... Përse dridhesh? përse?.. Një lot shkëlqen në syt e tu...

Asnjë lëvizje. Një lot ka ngrirë në syt e saja.

Eshtë loti i fundit i urisë... Romantika e urisë.

THE JOURNAL OF ANTHROPOLOGY 1934

OK
MUSA JUKA.

1991-1992 vjeti

Ju mund të mendoni se është poshtërsi të luftosh një njeri nga i cili dridheshe kur ishte ministër në fuqi. Keni të drejtë. Musa Jukën s'pata fatin e mirë ose të keq që ta njoh. Po! As nuk ja kam parë fytirën. As ai mua! Nuk më ka dërguar në Fier, as në Porto Palermo, se unë s'merrem me politikë... Për mua, Musa Juka, është një hije e frikëshme prej tē thënavet.

Atëherë vjen pyetja: «Përse i konsakron një kronikë njeriut tē cilin s'ta ka zënë kurrë syri?» Ke hak mor vëlla, po ku e di ti për cilin Musa Jukë do tē flasim ne sot?

Ka raste në Korçë (sidomos midis tē martuarvet me një vatrë fëmijë) që Musa Jukë i thonë gruas dhe vjerrës Se ashtu si qeveriste Musa Juka punët e shtetit, po ashtu sillen kundrejt nesh edhe gratë tona, kur u hipën në kokë.

Kur tē pyet nonjë shok: «Pse s'del ndonjëherë natën?» mund t'i përgjigjesh: «s'më lë Musa Juka».

Kur ke dëshirë pér tē zbutur gurmazin e tharë, duhet tē marrësh lejë nga Musa Juka. Kur pyeta një hallexhi: «Përse del natën e mbush ujë, kurse tërë ditën e ke tënden?» Ai m'u përgjegj: «Se kështu jep urdhër Musa Juka».

Fakti qëndron se, ndonëse Musa Juka nuk është ministër në Tiranë, këtu në Korçë vazhdon tē qën-

drojë fuqiplotë. Nuk dihet në do t'i japë lejë qeveria Musa Jukës të votojë; nuk e di, se s'merrem me politikë. Po në ardhtë ajo ditë, si lum beqarët! Ata mund të ecin rrugës, të takohen me duzina Musa Juka dhe të mos ja u varin torbën. Po ne teveqelët jemi gadi të themi: «Peqe Musa Efendi; si urdhëron Musa Efendi...» se ndryshe luan fshesa!

Arbenia, 14-I-1936

... d... jum odo... omisloch mabs valitnob og välladutob
... mabs... A tħallix u għixx-xu i... jidha busi
... u... mabs... mabs... mabs... mabs... mabs...

arab, 5-9, paxiex

KUR DHĒMB DHĒMBALLA.

Më dhëmb dhëmballa! Vdiqa pér Zotin që éshtë njé! Prandaj mora penën tē shkaravis ndonjé budalllek, dhe ndofta e harroj dhembjen. Se çfarë do tē shkruaj, as uné nuk e di. Më dhemb tepér għermadha! Trutē i kam dhallë. Ju që e keni ndjerë kêtë dhembje, besoj t'i kuptoni këto radħe. Nuk di uné si ta filloj dhe c'titull t'i vē këtij shkrimi. Dua tē shkruaj diċka mbi madħeshtiné e vaporeve anglezé, që pacifikisht po vërtiten né Mesdhe, po s'mé lë qyqja dhëmballé. Dua tē shkruaj disa radħe mbi luftén «pa din e pa iman» midis Italisé dhe Abisinisé, po bushtra dhëmballé nuk më lë. Më dhëmb tepér. Pena ime vjen vërdallé midis gisħtrinjéve që dridhen si purtek. Harrova borxhet, harrova hallet e jetēs, harrova që jam martuar, harrova që fēmija më kérkon kē-pucé, harrova ċdo dhëmbje tjetr, vetġem njé dhëmbje ndjej; atē tē dhëmballés. Ah, sikur tē më pushoġe e mallkuara! Do tē jem njeriu më i lumtur né botē. Tē paktēn asħtu më duket tashti.

Në shkrimin tim mendova t'i thurja bejte tilċjan-nes sē plakës, kambillafit tē prifit, qylafit tē ho-xħes, ose gisħtit tē deputetit. Po ku tē lë dhëmballa? Pastaj, uné s'merrem me politiké.

Njé kockë mikroskopike brenda né gojē ka fuqi tē demoralizojé njé gjigand siġġ éshté njeriu. Eshté e vörtetē se Zoti ka krijuar dentistet pér tē na hequr

dhëmballët; po dentistat duan dollarë... dhe sot dollarët sikur u shtrenjtuan të shkretët! E mallkuara dhëmballë, më dhemb, po s'kam c'bëj...

Arbëria, 9-2-1936

DHËMBI I URTËSISË

Nuk e sjell dot ndërmend moshën kur më doli dhëmbi i urtësisë, po jam i sigurt se qysh nga ai vit, nisa të mendoj si filozof. Çdo njeriut i jepja këshilla dhe për çdo çështje isha i pari të çfaqja mendim. Bile, në mos gabohem, atë vit jam martuar. Dhëmbi më frymëzoi ide të larta mbi jetën.

Të gjithë e dini ç'është ky dhëmb, që mban emrin tingëllonjës: dhëmbi i urtësisë. Ndodhet në anën e djathtë të nofullës së poshtëme, është i vogël dhe mund të ceket me gjuhë. Çdo njeriu i mbin në një moshë kur i ka kaluar të njëzetat. Dhe tregojnë shumë anekdota rrëth këtij dhëmbi të famshëm. Një dentist më tregonte se, kur ja hoqi një burri këtë dhëmb, burri u marros. Atëherë dentisti u detyrua t'ja ngjisë përsëri...

Shumë vetave u ka ecur mbarë. Një deputet më tregonte se, kur i doli dhëmbi i urtësisë, u bë deputet...

Shkrimtarit P. dhëmbi i urtësisë i doli atë vit që kapi «demin prej brirësh»¹⁾

F. P. i doli dhëmbi i urtësisë në periudhën kur botoi antologjinë e famëshme me filipikën e Faik Konicës kundra Plakut Vlonjat^{2).}

1) Është fjala për publicistin T. Pika i cili polemizoi kundra K. Cipos për çështje gjuhësore.

2) Faik Konica në gazeten Dielli u përpoq të denigronte Ismail Qëmalin.

Gjithë ish-ministrave u ra dhëmbi i urtësisë para se të binin nga kulltuku. Thonë se M.SH. i dhëmb dhëmbi i urtësisë dhe dentisti e këshilloi ta nxjerrë. Mirépo Mihali s'do, se kush e di?!

Tregojnë se Kryeministrit i mbju dhëmbi i urtësisë dy javë para se të bëhej kryeministër.

E ku ta dish? Sa gjëra thuhen, s'duhen besuar..

Tregojnë se Krishti dhe Muhameti lindën me dhëmbin e urtësisë në gojë. Thonë gjithashtu se diplomatëve u ka rënë dhëmbi i llogjikës. Thonë, thonë... po mos besoni. Gjenjeshtra me bisht.

Arbëria, 12-I-1936

se njeq i tanit është shembulli kom. nr. 108 që dhëbet
në mënyrë qëllimë e përmendur së paktën që bëhet
mësimtar i mësuesit të shkollave mesore, mësimtar i mësuesit
dëmshëm i përmendur qëllimë e shkollave mesore, mësimtar i mësuesit
dëmshëm i përmendur qëllimë e shkollave mesore, mësimtar i mësuesit
dëmshëm i përmendur qëllimë e shkollave mesore, mësimtar i mësuesit
BALTA QIELLORE¹⁾

Një mik më dërgoi nga Korça letrën që vijon:

«I dashur mik, ka tri javë që Zoti (i paçim uratën), na dërgoi prej qielli baltë; ra një farë shiu i kuq si flori dhe na bëri helaq të gjithëve ne që ndodheshim jashtë pa ombrella.

Një gjë e tillë na habiti pa masë, se ne prisnim misër nga lart, kurse qielli na lëshoi baltë.

Vranë mendjen tërë filozofët e Korçës, po nuk ja gjetën dot zgjidhjen misterit qiellor; se baltë Korça ka sa të hanë qentë, prandaj ç'e shtrëngoi Fuqiplotin t'i bënte Korçës këtë peshqesh jo të nevojshëm?

Në krye na u duk se balta e kuqe ishte baltë florëri dhe e pritëm me gëzim të madh. Pastaj vumë re se ish një baltë e qelbur²⁾, si mos më keq, o Zot! U bënë lutje në kisha e xhamira që ta zbusin të

1) N'ato kohë, në Korçë, ka rënë me të vërtetë një shi me baltë dhe thuhet se reja kish ardhur nga zbërthimi i vullkanit të Etnës.

2) Katër ditë para kësaj kronike, më 7-XI-1936, Zogu kish rrëzuar qeverinë e Mehdi Frashërit, gjoja më përparrimtare, dhe kish sjellë përsëri në fuqi atë të obskurantistit, Musa Jukës.

Aluzioni politik shumë i largët bëhet më i qartë duke marrë parasysh këto data.

madhin Zot, se mos ndonjëherë, në inat e sipër, në vënd të baltës na lëshon shkëmbij. S'dihet përfundimi i lutjeve. Jemi kuriozë të dimë në u muarën parasyshë ose jo. Ju Filozofët e Tiranës, ç'mendoni?»

Këtu mbaron letra e mikut tim. S'di as unë ç't'i përgjigjem. Vetëm e këshilloj të këndoja dhe të mësojë përmendësh këto dy strofa të të çmendurit Omar Khajam:

«*Më linde pas dëshirës fuqiplotë,
Më le të mbytem nëpër llom e lotë,
Tani tregomë ç'është më e fortë?
Mëkati im, apo mëshira jote?*

«*As kisha, as xhamia nuk më nxë,
Natyra më gatoi s'di me ç'hilë,
Si grua pa lezet, dervish pa fé,
Në quell pa shpresë dhe pa shteg mbi dhe.*»

Këndo këto, or mik, dhe mos u bëj merak pér baltën që bie nga lart. Se di ç'bën ustaj.

Arbënia, 12-10-1936

AUTOBIOGRAFIA E NJË TË MARRI

Një kokëkrisur më tha:

«Nuk i kam fare të kthjellta në mendje, orët e para të lindjes sime. Aty këtu, disa kujtime të errëta, të humbura në thellësirat e trurit.

Ishë ditë prilli.

Mëngjezi porsa kish filluar të zbardhëllonte. Ora e lirisë tingëlloi. Nëndë muaj i burgosur në barkun e mëmës. Dhe më së fundi dita agoi. Mamia (aso kohe këtë zanat e kryenin disa shtriga), më mori në duar dhe bërtiti:

«Mashallah, sa i bukur qenka! Ky djalë do të bëhet njeri i lartë! Duket si pëllumb.»

Unë kisha pasqyrën për karshi. Kur e pashë veten në pasqyrë, m'u duk shumë e shëmtuar. Nga inati vadita çitjanet dhe duart e mamisë. Dritë! Nëndë muaj errësirë. Më së fundi liri! Ç'liri e zezë! Më lidhën kok'e këmbë më një djep. Pyeta:

«Përse më lidhin? Ç'kam bërë? Unë nuk jam as diplomat, as kriminel. Përse më lidhin?» Këto mendoja, por nuk i shprehja dot, se nuk dija shqip. Në dy ditë nuk mund të mësojë njeriu shqip, megjithëse ka njerës që tërë jetën e tyre shkruajnë e flasin shqip, dhe nuk e dinë këtë të shkretë gjuhë. Kështu i lidhur siç isha, vinish gjithë koleksioni i plakave të fshatit dhe lëshonin mbi fytyrën time tërë jargët e tyre. Kur shikoja nonjë plakë se po më afro-

het, blegërija si kec. Qaja, pëlcisja nga inati. Nuk i harroj kurrë ato buzë të palara, të trasha, të thata, rudha-rudha, që më gërvishtnin buzët dhe faqet. Ç'lumtëri pér mua kur më vinte e më puthte ndonjë zonjushe!

«Ah», thosha me vehte, «kur s'jam njëzet vjet më i madh, që ta merrja pér grua këtë çupë të bukur që më puth!»

Një ditë (pa më pyetur) më muarën e më përplasën brënda në një kazan me vaj. Më xhveshën lakuriq. Më erdhi qahmet, u turpërova, u skuqa nga fytyra, se në gjithë ata njerës kishte gra dhe çupa. Ato nuk u skuqën, kur më panë lakuriq.

Një burrë i gjatë, me mjekër të zezë, bërtiti: «Luan!» Dhe që atëhere, njerëzit më thirresin: Luan, kurse emëri s'kish lidhje me mbretin e pyjeve, se unë kam frikë edhe nga hija ime. Nejse, mos kërko të kuptosh se shkallon mënc.

Në kazanin me vaj ngriva së ftohti; një shpirtmirë e vuri re (se unë i shkela synë) dhe më nxori.

«Shyqyr që dolla,» thashë me vehte, «pa jo Luan, por edhe Ujk të më quanin, s'ka rëndësi!»

Një vit më vonë u bëra burrë! Plakat vinin e iknin dhe nuk ngopeshin duke më puthur. Kushedi se ç'u kujtonin faqet e mia...

Njera, ajo më shtriga, më e thata, më surrat-sëszja nga të gjitha, ma bëri borxh! Tri herë ditën më lëshonte jargët e saja mbi fytyrë. Unë ja bëra benë. Ditën që mbusha plot 365 ditë, erdhi përsëri. Kur më pa, tha:

«Mashallah! Si Luan që e ka emrin, ashtu e ka dhe fytyrën!

Në të vërtetë unë isha i dobët si mace. Prandaj nuk m'u durua. Kur ajo më pështyti në fytyrë që të mos bija në sy, unë e pështyta dy herë nga inati.

Ajo hapi sytë, fshiu faqet dhe tha: «Ky qenka buda-lla! Ky s'paska terbie!» Dhe ma bëri benë që atëhere.

Pas njëzet vjet e mbajti inatin, dhe më bëri dhëndër. Ajo u bë vjehra ime.

Një ditë, kur festja më vinte rrrotull, se nuk dija si t'i përgjigjesha rrobaqepësit për borxhet, ajo më afrohet dhe më thotë:

«E di pse të bëra dhëndërr? Nuk e kam harruar edhë atë fyerjen që më bëre këtu e njëzet vjet më parë. Mban mënd apo jo?

«Po, po, e mbaj mënd», ja preva i hutuar.

Shqiptari nuk e lë hakën pa.... dhe ajo po e merr dita ditës!... shtriga. Por bota është e rrumbullakte. Në u bëfsha dhe një herë djalë, do të di të nusëroj.

Anthologji, Tiranë, 1940

V A K È F I

...Një djersë e ftohtë përshkoi anëmbanë trupin tim të raskapitur prej mundimevet të ditës...

Hyra pa dashur në një pyll të madh, të dendur, të bukur si parajsa atje sipër.

Lloj lloj pemësh e zbukuronin atë vend të uruar. Lloj lloj zogjsh fluturonin bashkë me këngët e tyre, dhe mbi të gjithë çapkëni bilbil e hijte vallen hyjnore. Në mes të pyllit; një teqë e madhe, e bukur, e rrethuar me kullusmat e gjelbëra brenda të cilavet kishin ngritur folenë mijra bilbila.

Karshi teqesë një manastir madhështor, i rrethuar me lulet më të bucura që ka bota. Një bari me krrabë në dorë kulloste dhëntë, i çkujdesur, gati i lumtur nga që atë ditë bisha nuk i kish rrëmbyer ndonjë dele.

— Or çoban, or çoban! Kush e ka këtë pyll të bukur?

Cobani, i hutuar, m'u përgjegj me inat: «Nuk je as i pari, as i fundit që më pyet si quhet ky vend; shumë të tjerë të huaj ma kanë bërë këtë pyetje dhe çuditem si bota nuk ka marrë vesh se në gjirin e saj ndodhet një vakëf; vakëf me të vërtetë i shenjtë, se kushdo që ka ardhur në pabesi të presë dru, është kthyer me sopatë të thyer në shtëpi të vet. Teqeja dhe manastiri që shikon atje tej mallkojnë ata q'u venë kundra ligjeve të Zotit, se Zoti paska thënë:

«Mos prit dru në pyllin e tjetrit, se të thyhet sopata». Dhe shumë sopata janë thyer gjer më sot, or tungjatjeta, dhe shumë lotë kanë rrjedhur në këtë vend të shenjtë, shumë burra janë bërë kurban për të mbrojtur vakëfin. Eja shiko me sytë e tu. Toka e zezë dhe pjellore është vadir me gjakun e atyre që i kanë rënë në qafë vakëfit dhe rrënjet e këtyre pemëve janë rritur me eshtrat e atyre djelmoshave që i kanë dalë për zot. Shiko këtë pemë... Sa e bukur, sa e madhe! I shikon në kurmin e saj dhe disa vija të thella që ndofta ja prishin bukurinë? Janë gjurmët e lotëve shekullorë, që kanë derdhur zhgabonjat kur nga maja e saj vajtonin trimat me fletë që binin me pallë në dorë...

— Të lutem, bari, as më thua, si quhet ky vakëf? Kush banon këtu, ku janë njerëzit e tjerë që nuk po i shoh?

Dhe bariu, pa m'u përgjigjur drejt për së drejti, duke vështruar herë nga teqeja, herë nga manastiri, bërtiti ashtu si e ka zakon:

— O Naim, o Andon. . . , na ka ardhur një mysafir dhe më pyet si quhet ky vënd; priteni dhe përcilleni ashtu si duhet.

Çava pyllin dhe kur po i afrohesha teqesë, nënë një pemë të madhe, vura re tre pleq mikpritës që ja kishin kurdisur muhabetit këmbëkryq.

Kur u afrova, m'u ngritën që të tre në këmbë me buzëqeshje të matur, po të sinqertë. I pyeta menjëherë të më tregonin emrin e atij vendi të shenjtë... Kur, pa pritur pa pandehur, një zhgabonjë m'u përgjegj nga maja e pemës. U hutova kur dëgjova zhgabonjën të flasë dhe... hapa sytë si i hutuar. Isha në ëndër.

Botuar në «Hylli i Dritës», mars-prill 1942.

VARRIMI I POETIT

Nga maja e Dhëmbelit plak, era sjell tingëllimën eëmbël të këmborëvet. Një kope dhënsh kullot atje sipër. Është kopeja e Pilos.

* * *

C'kujtime më sjell ndër mënd ky emër: Pilo! Ishte biri i tretë i një bariu në një katund shumë të vogël, por tepër të bukur, pranë Përmetit. Meso burrë, me një fytyrë vezake, Pilua nuk dinte as shkrim as këndim. Por sytë e tij të zez si nata, trigonin se në shpirtin e tij flinte i shqetësuar një duf i pashfrehur. Ishte poet! Poet me gjithë kuptimin e fjalës, poet nga më të mëdhejtë. Po nuk dinte ai se ka në botë vjersha dhe vjershëtarë. Nuk pati rast të mësojë kurrë një gjë të tillë. Megjithatë jetonte si i dehur. I dehur prej erës së trendelinës, prej tingëllimës së zileve, prej rrëkeve që zbrisnin si të tërbuara nga majat e malevet. Ishte i dehur prej mëmës natyrë. Tek ajo pat hedhur dashuri. Atje në gjirin e saj e shkoi të shumtën e jetës së tij.

Kishte nja njëqind e ca dhën dhe i njihte një për një dhe i thërriste emër me emër të gjitha.

Një ditë i ati i flet për martesë. Pilua nuk përgjigjet as «po», as «jo». Më së fundi martohej, ndonëse që prej kohe ish kurorëzuar me malet dhe kodrat që e rrëthonin. Martesa i fali tre-katër fëmijë; por Pilua nuk hoqi dorë nga poezia se ishte mishërimi i poezisë vetë. Qysh në moshën katërmëbëdhjetë vjet vrau një zhgabë vetëm e vetëm për t'i marrë kërcinë. Dhe me atë kërci bëri një fyell aq të bukur, sa vinin njerës që nga larg për ta parë. Po ku ta shihnin e si ta shihnin? Pilua rrinte nat'e ditë maleve. Nga maja e bregut të Kallamaqit tingëllonte në veshët tanë zëri i fyellit të Pilos. Vetëm kur katundi për karshi ishte kredhur krejt në gjumë, atëherë kur bindej se nuk e dëgjonte njeri, vetëm atëhere i binte me gjithë qejf fyellit.

Ai nuk dijti kurrë q'është paraja; nuk vuri kurrë një grosh në xhep të tij; bile nuk e pranoi kurrë vlerën e saj.

Të tjerë kujdeseshin për shtëpi. Pilua nuk dijti tërë jetën e tij veç se t'i bjerë fyellit dhe të ruajë dhëntë.

Ditën e pashkës së madhe i ati i blinte opinga të ra për të vajtur në kishë; po dhe atje kur vinte, rrinte nga fundi pranë derës gati për të ikur me të mbaruar mesha. Vitet fluturonin, por Pilua nuk mplakesh, dukej sikur natyra e pashpirtë për ne, kish mëshirë për mikun e saj të pandarë.

Ditën që vdiq i ati i Pilos, vdiq dhe Pilua vetë; vdiq shpirtërisht; përçolli kokëulur tanë në banesën e fundit, dhe pastaj mori malet. Nuk ia kishte ënda që lotët e tij t'i shikonin të tjerët; por atje lart në shkëmbjtë e egër qau me lot të hidhur. Zambakët dhe trendelinat që e rrëthonin ia thëthiten ata lot.

Atje lart prapa kodrinës së lulëzuar bashkë me Pilon dukesh sikur qante dhe bilbili shoku i tij i pandarë, sikur lotonte Balua besnik, dashi syskë me këmborë, ndërsa rrëkeja e rrëmbyer i freskonte fytyrën poetit. Qau në mes të asaj natyre që e ushqeu dhe e rriti në gjirin e saj. Qau ashtu si di të qajë një poet.

* * *

Tre muaj më vonë një bari me mjekër ngjitet malit përpjetë. Qime të bardha i zbukurojnë kokën. Ishte Pilua. Kish vendosur të mos e rruante mjekrën gjersa të viste. Fyellin e kish mbështjellë me një shami të zezë pranë hanxharit. Pastaj ca nga ca nisi të tretet. Pas dy vjet vdiq dhe u varros ashtu si desh me mjekër në fytyrë, me fyell në bres të pështjellë me shami të zezë. Ç'varrim tragjik ka qenë ai! Rreth e rrotull tij njerëz. Ç'punë kishin njerëzit në varrimin e Pilos? Asnjë fëllënë, asnjë bilbil, asnjë gjeraqinë, as dashi me këmborë nuk muarën pjesë në varrimin e Pilos. Vetëm Balua qëndronte i hutuar dhe i habitur në bregoren për karshi dhe shikonte gropën në të cilën u kall trupi i të zot. Kur njerëzit u larguan i afrohet varrit, i mer erë baltës, qëndron pakëz si i menduar dhe pastaj ngjitet me shpejtësi malit përpjetë. Ndofta vajti t'u japë shokëve të poetit lajmin e hidhur.

Shkëndija, gusht 1940

BARDHI PROTAGONIST

Vendosa të thur një novelë.

Një novelë têrheqëse plot pérshkrime të bukura, plot frymëzim, plot ndjenja të larta.

Një novelë nga ato që do të çuditin gjithë botën.

Prej kohe kisha marrë një vendim të tillë; mirëpo pena nuk shkiste; idetë më mungonin; fantazia më ishte arratisur. Sot e ndjej veten në rregull. Dhe iu përvisha punës.

Gjëja e parë pér një novelë është protagonisti. Prandaj duhet gjetur medoemos një i tillë. Rreth tij do të vërtitet i tërë veprimi ashtu si kali vërtitet rrëth strumbullarit kur shin grurë. S'ka nevojë të shtoj se protagonisti i novelës sime do të ketë mend më tepër nga kali i strumbullarit.

Dhe tashti vjen puna e emrit.

C'emer t'i ngjit? Duhet pagëzuar medoemos, dhe emri duhet të ketë sex-apeal, që të dalë novela me fe.

«Bardhi!» Hajde me trashëgim. Tashti që mori fund pagëzimi, le të fillojmë nga puna seriozisht, se kemi premtuar një novelë të bukur; dhe fjala duhet mbajtur ashtu siç u ka hie burrave të ndershëm.

Që thua zotrote, ku e kishim fjalën? Hë! po. Te Bardhi.

Duhet bërë një derman pér 'të. Protagonist i thonë, s'është shaka.

Bardhi qëndron para meje lakuriq ashtu siç dolli nga kazani i pagëzimit dhe pret urdhërat.

Kam pështjellë kokën në dy duart dhe mendohem si t'i filloj aventurat e Bardhit.

Duhet një farë plani për të dalë novela taze si simite Elbasani.

Mirëpo as plan as dreq kam bërë. Dhe fjala e dhënë duhet mbajtur.

Them ta bëj Bardhin doktor. Por kam frikë mos dalë ndonjë biçim Molieri dhe e akuzon se shëron kallot e këmbëvet me kinino.

Them ta bëj arsimtar, po trembem mos ja marrë ato dy tru që ka algjebra dhe gramatika.

Them ta bëj avokat, por publiku do të thotë se Bardhi e bën të bardhën të zezë.

Them ta bëj ministër, po kam frikë mos i ngrihet hunda.

Mendoj ta bëj diplomat, që të mos gënjejë kurrë. Mirëpo pa gënjeshtra nuk rrrohet.

Them ta bëj... them ta bëj...

...Kuspull të bëhet ai me mua bashkë, se nuk di nga t'ja filloj. Bardhi më ka zënë derën dhe s'më shqitet.

Ta bëj oficer? Po sikur të vejë në luftë dhe të hajë ndonjë plumb? Atëherë lumi që na mori, se novela mbaron pa lavdi; kurse ne premtuam një novelë të bukur, tërheqëse dhe të gjatë.

Vërc këtej, vërc andej, pena vërtitet dhe Bardhi qëndron para meje lakuriq, ashtu si ka dalë nga kazani i pagëzimit. Pret vendimin tim. Pret një urdhër. Më vështron me sytë e tij të kaltër dhe duket sikur thotë:

— Tashti që më nxore në botë, bëmë derman, se ndryshe na mori djalli edhe ty edhe mua, edhe novelën tënde të famëshme.

Ka hak i gjori. Mirëpo edhe unë kam hak.

Ta bëj kapiten vapor?

Kam frikë mos ka stomak të dobët dhe e zë deti, ose mos përpinqet me ndonjë nëndetëse dhe hajde ta peshkosh në fund të detit.

Ta bëj nonjë aventurier, që të shetisë në popuj barbarë ose gjysëm barbarë (1), trembem se mos e kapin antropofagët dhe e bëjnë pastërma për di-mërin që vjen, sidomos tashti që mishi vajti një djall e gjysmë.

E pyes:

— Mor Bardhi, a bëhesh poet?

Pa pritur e pa pandehur, pa ngurim, m'u përgjigj:

— Më pëlqen shkëlqimi argjendar i hënës; i adhuroj retë e bardha kur kapërcejnë me nxitim mbi kryet tona; më mallengjen zëri i bilbilit, kur deperton prej degëve të gjelbëruara të një pylli virgjër.

— Po sikur pylli të mos jetë virgjër, a të pëlqen zëri i bilbilit, o Bardhi?

Ai e mori vesh romuzin tim dhe nuk m'u përgjigj.

— Mor Bardhi, lumëmadh, unë nuk të pyes çfarë të pëlqen. Unë të pyes a je i zoti të shkarravitësh shtatë a tetë vargje nëpër revista, për të fituar nonjë lek? Këtu ta kam fjalën, o teveqel, dhe jo te hëna, te retë, te bilbili e bilmemë.

Këtej lumë — andej det — Bardhi i zi — medet, medet — si statujë na ka mbet, si shenjtor qëndron para meje. Më mbiu në sy. Kalemi që shkarravit këto radhë po e rrallon vrapiimin e tij. Trutë e atij që

1) Xhovani Papini, shkrimitar fashist italian, kish shkruar aso kohe se populli shqiptar është gjysëm barbar.

shkruan, po bëhen dhallë. E humbi krejt pusullen. Kur një klithmë prapa meje, e pa pritur, gjëmon:

— Akoma s'ke shkuar në pazar pér të blerë kafe, sheqer, bakalaro dhe sapun? — Harroi të shtojë dhe litarin.

Se me tē vërtetë ajo që vendosa tē blej ishte litar i dhe sapuni për tē varur veten time dhe Bardhi zinë. Mirëpo as atë s'e bëra. Kështu që as novela u thur, as premtimi u mbajt, dhe Bardhi u zhduk për ndonjë majë pene më tē prehtë nga kjo imja.

Shkëndija, maj-qershori. 1941

VDEKJA E PROFESORIT

Bardhi, protagonisti virtuozi i novelës sime të mëparëshme, më nxiu faqen ose më mirë më koriti, si i thonë shkodranët. Prandaj e thirra përsëri në fantazinë time që ta rifillojmë novelën e pambaruar, dua të them të pafilluar. Dhe ai erdhi.

— Bardhi, të kam thirrur sot për një çeshtje me shumë rëndësi: novela e parë që desha të qëndisja me ty si protagonist, nuk doli gjë; hajde të përpinqemi këtë rradhë së bashku mos e qullosim dot.

— Zotni! — përgjigjet Bardhi me zë tingëllonjës, — nëqoftëse zotrote i shkruan novelat me këmbë dhe jo me duar, siç ka urdhëruar i madhi Zot, nëqoftëse pena e zotrisë sate nuk shket lehtë mbi letrën e bardhë, ç'faj kam unë? Unë u bindem urdhërave. Zotrote, po qe se nuk je i kënaqur nga vehtja, thyje penën, ndërro zanat dhe bëhu hallvaxhi, arabaxhi, bakall ose garson; puna s'ka turp.

— Bardhi, pusho, se ma solle në majë të hundës! Mblidh gojën se të bëj atë që s'ta pret mendja.

Dhe para se të merrja një vendim të prerë rrëth këtij protagonisti rrëbel dhe fatkeq, desha t'i bëja propozimin e fundit:

— More Bardhi, a bëhesh prift?

Ai vrejti vetullat dhe m'u përgjegj:

— Megjithë qejf do ta pranoja, po kam frikë mos më ngjasë si Kordinjanos (1).

1) Prift jezuit italjan, që banonte në Shqipëri; denigronjës i popullit shqiptar.

— Ç'ka bërë ky Kordinjanua, more Bardhi?

— Ai përbysni kupën atje ku hëngri bukën, — m'u përgjigj Bardhi me zë të ulët.

Atëhere i dhashë karar ta vras protagonistin tim. Frikë nga xhandarët nuk kam; ne që merremi me shkrime, e kemi atë privilegji; vrasim sa të na teket dhe si të na teket, pa u trembur nga gjyqi dhe nga burgu. Tashti çeshtja qëndron që ta vras në një mënyrë origjinale që s'e ka bërë njeri gjer më sot. Prandaj po vras mendjen para se të vras Bardhin.

«T'i bie me kobure?» S'ka kuptim, se shumë të tjerë para meje e kanë përdorur këtë mjet.

«Ta farmakos?»

Edhe helmit i doli boja. Edhe ky mjet u bë bajat.

«Ta hedh në pus?»

Kam frikë se qelbet ujët, pëlqet tifua dhe hajde të meresh vesh me doktorrët.

«Ta përvëloj në zjarr?»

S'ka hesap, se drutë kanë vajtur një djall e gjysmë, dhe ky mjet u përdor në Mesjetë.

— Bardhi, preqatit testamentin, se të qau gërmadha! Vendosa të të zhduk.

— Pse zotni? Unë jam i pafajshëm!

— E di që je i pafajshëm, por ç'pandeh ti, se vëtëm të fajshmit dënohen?

Ndjej një kënaqësi të përzier me frikë pér vdekjen e një njeriu të fantazisë sime; më kot përpiqem të gjej vdekjen origjinale të premtuar. Mëndja nuk pjell çdo minutë origjinalitetë. Çdo gjë që thuhet ose shkruhet, është thënë dhe shkruar prej të tjerëve.

— Bardhi, ke leje me pasht ta zgjedhësh ti vetë vdekjen tënde. Ku gjen një favor kaq të madh protagonisti prej novelistit?

— Jo, nuk dua të vdes, jam akoma i ri, e kam të ardhmen përpëra. Dua të thëthij edhe unë mjaltin

e jetës. Dua të jem një protagonist i ndershëm, i bukur, trim, serios, simpatik dhe i pasur. Dua të martohem, të kem grua e fëmijë si gjithë bota. Përse të vdes aq i ri?

— Unë të lejoj të zgjedhësh mënyrën e vdekjes dhe jo atë të jetës!

Fytyra e Bardhit u zverdh si lejmoni dhe buzët i dridheshin. E ndjeu gjallë vendimin tim të prerë. Në atë çast një shkëndijë origjinaliteti përshkoi fantazinë time të shthurur. Ja mbërtheva sytë për të fundit herë Bardhit dhe i thashë:

— Bardhi, ti do të bëhesh profesor gjeografi-je (1). Ti do t'u mësosh nxënësve shtetet e ndryshme të botës, sa popullsi ka secili shtet, dhe kufijtë që ndajnë njerin prej tjetrit.

Bardhi lëshoi një buzëqeshje enigmatike dhe pëshpëriti:

— Nesër ndaj të gdhirë do të të jap një përgjigje.

Të nesërmen Bardhi u gjend i vdekur. Kish hedhur trutë në erë.

Testamenti që kish lënë përbante këto fjalë:

«Eshtë më lehtë të gjesh peshk në mal të Dajtit, se sa të bëhesh profesor gjeografije në kohët tona. Bardhi.»

Shkëndija, korrik 1941

1) Ishte ajo kohë kur fuqitë e Boshtit, dhe veçanërisht Gjermania hitlerjane, gllabëronin njeri pas tjetrit shtetet e Europës dhe çduknin kufijtë, me sot, me nesër.

NJËQIND FLAMURË, PA NJË

Ishte ditë vere në një nga qytetet më të mëdha të Arnavutistanit. Ecja filli vetëm duke menduar për hallet e kusuret e këtij vendi heroik, por shumë fatkeq. Vapa përvëlonte. Djersët më kullonin rrëke. I kredhur në të thella kapërceja nga një ngjarje në tjetrën.

Shikoja me sytë e mendjes vendin e shkretuar prej tufanit, tërmelin që po trondit botën dhe që po kthen në shkrumb e hi atë që dora e njeriut e ka ngritur me djersë e gjak. Habitesha me shtazëritë njerëzore. Në këto të thella isha kredhur, kur... fiu, fiu.... sirena — Bum, bum, bum! — krisi topi.

— Bobo, — thashë, — erdhën lanetrit e qiellit, shpikja moderne më e mrekullueshme për të çfarosur njerinë.

Pa e vrarë mendjen më thellë, hyra në shtëpinë e parë që gjeta aty rrotull. Mysafir i paftuar, hapa derën e rrugës, pastaj atë të brendëshmen dhe instinkti i vetëmbrojtjes më drejtoi në një bodrum të sigurtë nën tokë.

— Ç'urdhëroni? — ma priti një zotni i cili me grua e fëmijë ishte struktur në një cep të asaj gropë të errët.

— Hyra këtu, mbasi jashtë po bëhet festë midis qiellit e tokës. Qielli sulmon tokën dhe toka i përgjigjet. Dhe unë, që s'jam as në qeill as në tokë, hyra këtu nënë tokë.

— A janë shumë?

— Nxin qielli katran, efendi.

— Allahalla! Si do të vejë ky halli ynë? Kur do të marin fund kusuret?

U ula mbi një fron gjysmë të thyer dhe po fshija djersët. Njeriu i bodrumit më lëshonte lehtë lehtë, me kureshtje, nga një bisht syri; sikur matej të më thosh diçka, por nuk guxonte. Më së fundi foli:

— Si duken punët, or zotni? Ç'është ky hall i madh që na ka zënë? Kur merr fund vallë? Ç'është kjo e keqe që i ka rënë në kokë njerëzisë anembanë?

Ndërsa ai po i qante hallin njerëzimit, unë po vërtitja sytë rrëth e rrotull atij bodrumi dhe vura re diçka që më bëri përshtypje:

— Përse i mban akoma syfetin e famëmadhit Duçe dhe flamurin me lulka të Imperos? Ti e di që ajo punë mori fund një herë e mirë.

— Ah, mor bir, (më lejo të të quaj bir) — ma priti hallexhiu i bodrumit, — një fjalë e vjetër thotë se bota është e rrumbullakët si top; njerës si unë që nuk merren me politikë i kanë marë masat për çdo gjë që mund të ngjasë... Sa ka parë ky qerra-ta vend!

— Po ky flamuri i Anglisë, pranë atij të Duçes, ç'kërkon këtu në bodrumin tënd?

— Ta thashë, mor bir, jam njeri esnaf dhe hallexhi. Sikur një mëngjes, pa pritur dhe pa pandehur, të kërcasë topi andej nga deti dhe të zbresin ata? Ku të shkoj e të gjej stofë për të qëndisur flamurin angles? Apo të ha ndonjë plumb rrugës? Kështu të paktën e kam mendjen të fjetur.

— Po Stalini me drapër e çekan, ç'punë ka në bodrumin tënd të errët? Mos je gjë dhe ti bolshevik?

— Jo, vallahi, bilahi s'jam. Por si esnaf njeri që jam, kur të shoh se të gjithë bota do të skuqen, si

mund të qëndroj unë i bardhë? Urtësia më këshillon të ngrë flamurin dhe të bërtas pas berihajt: «Rroftë!».

— Qenke plot tru efendi. I paske marrë masat me kohë.

— Po si, po si, ç'të bësh? Ja! Po fitoj para me grushta, si hallexhi që jam. Kam tre djem dhe që të tre i kam ndarë në tri parti të ndryshme; kështu, nga do që ta kthesh, i kam shpatullat e ngrohta.

— A ke ndonjë djalë në mal?

— Jo bir, jo. E kam vërtitur punën që mishi tē piget dhe helli tē mos digjet. Jam njeri i punës dhe jo i politikës. Kur ishte Zogu mbret, unë isha zogist. Kur iku, nuk i thashë as udhë e mbarë.

Kur pllakosi ushtria e Duçes, i dola përpëra me flamur dhe tashti që u largua i dhashë munxët nga prapa. Kur erdhi gjermani e kisha gati fytyrën e Hitlerit dhe flamurin me kryq tē thyer. Kur tē shkojë, edhe këtë do ta zë me gurë, për t'i bërë qejfin atij që do tē vijë pas tij. S'ke ç'bën, duhet tē jetosh me nder në këtë botë.

Mbeta si i trullosur nga predikimet morale tē atij njeriu tē njobur dhe tē panjohur që ma hapi aq thellë zemrën; rashë në mendime, duke kullotur sytë zrreth e rrötull bodrumit ashtu si nëpër èndërr.

Në një cep më vranë syrin disa flamurë tē tjerë.
E pyes:

— Po këta ç'janë?

— Ky është flamuri i Grekut, — më tha efendiu.

— E mora vesh, zotrote qenke grekoman, o efendi.

— Jo bir, jo, nuk jam as grekoman, as djall; por, kur ushtritë e Grekut hynë thellë në vendin tonë kundër italianëve, porosita shpejt e shpejt flamurnin e tyre që tē mos më zinte në befasi. Ja dhe flamuri i Turqisë, që po e ruaj si kujtim tē baba-dovletit;

pranë tij, ja dhe ai i Sërbit. Të thashë, or bir, se jam njeri me parime, me karakter, me edukatë dhe s'ma këndë ta prish muhabetin me asnje kral që mund të shkelë këtë vend.

U ngrita më këmbë, u solla dy tri herë rrëth atij muzeu origjinal që mund të pagëzohej me emrin tingëllonjës «muzeu i karakterit», dhe sytë m'u mbër-thyen mbi një flamur të quditshëm, të bardhë si dé-bora, me një rrëth të kuq në mes.

— Po ky i kujt është, mor efendi?

— Ulu, — ma preu ai, — se është një punë e gjatë që të ta spjegoj. Disa vjet më parë po rrija në një kafe duke pritur një mik, ortakun tim, me të cilin dërgonim fasule në Greqi; duke pritur mikun e fasu-levet, në tryezën aty pranë, disa biçim shkollarë, bisedonin pér politikë. Ishte ajo kohë kur kish nisur lufta midis Japonit dhe Anglo-Amerikanëve. Japoni po korre fitime aq të vrullëshme sa asnjeri nuk mund të parashikonte se ku do t'i mbanin këmbët anglezët dhe amerikanët. Një nga shkollarët hidhet e i thotë shokut: «Ashtu si ka nisur puna, s'është çudi që një ditë të shohim japonezët të vinë gjer në Tiranë!» Sa dëgjova këto fjalë, shpejt e shpejt bëra gati edhe flamurin japones. Kështu më zuri gjumi rehat.

Bombardimi kishte marrë fund. Sirena më lajmëroi se kishte ardhur koha pér të dalë nga strofka e atij idealisti. Ndërsa po matesha ta përshëndesja, befas më ra ndër mend diçka dhe e pyeta:

— Të falënderoj, mor efendi, pér mësimet e larta të moralit që më dhe, por as më thua, të lutem, në gjithë këtë grumbull flamujsh dhe fytyrash, si nuk ma zuri syri asgjékundi, Skënderbenë dhe flamurin kuqezi?

Efendiu ngurroi pakëz si i menduar, rrrotulloi

sytë andej këtej, pastaj duke m'i mbërthyer si me frikë, më thotë:

— Ke hak, ke hak. S'më kishte shkuar ndërmend; e ku ta kesh mendjen më parë, në këtë kohë trazirash dhe përleshjesh?

Pastaj me autoritet i drejtohet të birit dhe i thotë:

— Kujtomë kur të vemi në dyqan të porosisim edhe një flamur të Shqipërisë, se s'dihet, edhe ai mund të na hyjë në punë!

Hapa sytë. Isha në ëndërr. Se idealistë të tillë s'mund të ekzistojnë vegse në ëndërr.

Revista Letrare, 1 gusht 1944

Polemikë me të vdekurit

FAIK KONICA KUNDRA NAIMIT

Në numurin e datës 28 Korrik 1937 të fletores «Dielli», zoti Faik Konica ja ka vënë në bina Naim Frashërit. Kësaj here Faik Beu ja filloi polemikës me kufoma të shenjta. I mohon kryekëput çdo vlerë letrare Bilbilit të Frashërit. Profesorë të shquar si Kostaq Cipo, njerës që dinë të përdorin penën, na kanë thënë dhe kanë shkruar se Naimi ka vlerë letrare, ka dell poetik. Jemi ushqyer, Faik Bej, me vjershët e Naimit dhe sot del zotrote dhe insiston që t'i vjellim ato se nuk paskan asnji vlerë.

S'don Faik Konica që Naimi të jetë poet; nuk i pëlqen. Po pse vallë? Se, po të rronte Naimi mund të ish zemëruar me 'të, mirëpo puna qëndron ndryshe: «Le coeur a des raisons que la raison ne connaît point»¹⁾ — thotë Paskali. Ndoshta as Faiku nuk e din pse e përbuz aq tepër Naimin.

«Naimi është poet i tototove dhe i tatatave» — thotë Faiku dhe tregon anekdotën që vijon: — Tridhjetë vjet më parë, një shqiptar prej Rumanije paska thënë se Naimi është Homeri i shqiptarëve. Faiku na e paska dëgjuar atë fjalë dhe na qenka

1) Zemra ka arsyë që arsyjeja nuk i shpjegon dot.

zemëruar, bile s'ka dashur të hajë as bukë nga inati. Mirëpo shqiptari prej Rumanije, Nikolla Naçua, e hoqi mënjanë Faikun dhe e siguroi se ato që tha për Naimin i kish shakara. Kështu i ra inati Faik Beut dhe u shtrua e hëngri bukë me oreks.

Këtë anekdotë e tregon vetë Faiku në artikullin «Helm e vrer kundra idolit të ditëve tonë djaloshare».

Tridhjet vjet më vonë, në vitin 1937, Faiku thur, ose më mirë ndërton me penën e tij një tabut ku duhet të varrosë Naim Frashërin si poet dhe si letrar.

«Naimi, jo vetëm nuk ishte vjershëtor dhe shkrimtar i madh, por nuk ish as i vogël. Nuk dinte të shkruante fare.»

Kështu thotë Faiku. Por nuk është ashtu.

«Vjershësia e Naimit, shton Faiku, është një grumbull dokumentash propagande politike, dhe asgjë tjetër.»

Për Faik Bejnë, Naimi s'ka as më të voglën vlerë letrare. Këtë na e provon duke cituar vjershat më të dobëta të Naimit. Dhe pastaj jep këshilla se si shkruhen kryeveprat. Zë në gojë Bosuetin, Swiftin, Floberin, La Fontenin. Dhe ankohet tërthorazi përsë Naimi nuk ka nxjerrë kryevepra si ata. Emrat e shkrimtarëve në fjalë i kemi dëgjuar edhe ne këndej nga ana jonë, Faik Bej. Bota ecën përpara. Shqipëria s'është më ajo që le zotrote. Ka edhe këtu njerës që dinë të gjykojnë dhe pak a shumë të çmojnë kryevepra. Por gabohesh trashësisht kur komenton Naimin duke pasur mbi tryezë Floberin dhe Bosuetin. Nuk gjykohen ashtu veprat shqiptare. Argumenti yt nuk është as bindës, as dërmues.

«Naimi ka shkruar «Vers de mirliton» që shqip u thonë vjersha të «tototove e të tatatave» — thotë Faiku.

Sa gjë e lehtë është të kritikosh një poet! Ja

gjen kurdoherë pikën e dobët. Po ta zesh ashtu punën, cili poet nuk ka të metat e tij? Edhe Hygoj, edhe Vinjiu, edhe Alfieri kanë strofa që mund t'i quash «budallallëke me thes» ose më mirë «pallavra» siç quan Faiku vjershësinë e Naimit.

Por poeti përgjithësisht është një e «Tërë», «Un tout». Në këtë të «Tërë» ka gjëra të mira dhe jo të mira. Faik Beu i lë mënjanë të mirat dhe na nxjerr në shesh vetëm të këqijat. Është vallë kjo një mënyrë për të gjykuar veprat e poetit që adhuron kryekëput një popull i tëré?

Në më të shumtata herë, Naimi, atë që ka shkruar e ka ndjerë. Dhe ajo që ndjehet nuk mund të shprehet veçse mirë, kur ka njeriu dell poetik. Mirépo nuk do Faik Beu që Naimi të ketë dell poetik. Del Davidi dhe i thotë Gcliadhit: Je gabuar! Goliadhi do të zemërohet pak; por s'kemi se ç'bëjmë. Kështu e ka kjo botë. Është e rrumbullaktë. Dhe si e tillë vjen rrrotull. Dhe duke ardhur rrrotull na ngre ose na zbret sipas kapriçios. Sot Faik Beu ka rënë poshtë. Se Naimi është vjershëtor i shquar. Pena e Faikut, sado e mprehtë, nuk ka si e kredhos në tokë. Arti nuk varroset me një artikull në fletore.

Naimi ka qenë poeti i ndjenjës kombëtare, poet lirik i radhës së parë. Ka qenë poet i dashurisë, i hidhërimit dhe i natyrës. Naimi di të shkruajë shqip fare bukur, fare kulluar. Këndo me vërejtje, Faik Bej!

*«Në fëtyrën tënde gjeta bukurinë,
Si ay që gjeti në mal Perëndinë.
Lulëzat e majit sa janë të mira,
Po përpara teje m'erdhën të pështira.»*

Imazhe të thjeshta e të goditura. Ku gjen kollaj një varg të bukur si ky?

«Pashë pjeshkëtë ndër fletë,
M'u kujtua gjiri yt.»

Faik Konica merr vesh shumë nga letërsia. S'ka si mohohet një gjë e tillë. Faiku del e thotë sot se Naimi nuk ka vlerë; kurse është i sigurtë se Naimi ka vlerë, bille shumë më të madhe nga ç'i është dhënë. Si shpjegohet kjo gjë? Një nga të dyja: ose Faiku s'merr vesh nga letërsia, ose nuk e ka kënduar Naimin. Kjo e dyta duhet besuar, se të parën e hoqëm a priori. Faiku e ka kënduar krejt përcipërisht Naimin.

«Naimi nuk vë re, as gjuhën, as arësyen.» — shton Faiku. Hem gjuhën, hem arësyen i vë re Naimi; po njeriu kur qorrohet nga pasioni nuk di ç'thotë.

Është për t'u quditur. Të gjithë thonë se Faik Konica është nga shkrimtarët më të mirë të Shqipërisë. E vërteta është se të paktë, shumë të paktë janë ata që kanë kënduar dy vepra të tij shumë të bucura, një origjinal dhe një përkthim. Dyzet e kusur vjet ka punuar Faik Beu dhe s'mundi t'i dhu-rojë atdheut veçse dy vepra, edhe ato të padukë-shme. Kësaj i thonë «fécondité». Nejse. Miletin venë pas berihajt... Pse bërtitën disa që në krye, se Faiku shkruan bukur, bërtitën edhe të tjerët më pastaj. Po, pse ka Faiku vlerë letrare, kjo nuk i lejon të shkruajë ç'të dojë. Syleshët nuk janë të këtij she-kulli. Çdo gjë nuk tret stomaku, qoftë edhe kur ajo gjë del prej penës së Faikut. Po le të kthehem i te Naimi.

Pena e Faikut vazhdon të vjellë dhe thotë:

«Pasqyra e stilit të tij ishin këngët e lipësve malishovitë, në gjuhën e tyre të shqepur dhe zvarranike që duket si të folurit e një çilimi të dehur.»

Naimi ka folur si një çilimi i dehur! Ja ç'ka shkrojtur ky çilimi i dehur Faik Bej! Lexo!

*«Do të shtrihem,
 Të venitem
 Si kandili kur s'ka vaj,
 Baltë e pluhur
 Do të bëhem,
 Të më shkelnjë këmb' e saj.
 E të prehem
 Duke puthur
 Atë këmbë pasandaj.»*

Në se ky që ka shkruar këto vargje është çilimi i dehur, atëherë Faik Bej, të një miljon shqiptarët (përveç teje), janë të gjithë çiliminj të dehur. Vetëm zotrote je esëll... Krejt të anëshme janë mendimet tuaja mbi Naimin. Krejt pa vend janë insinuatat tallëse. Naimi s'ka si përgjigjet. Se ka vdekur shumë vjet më parë. Po shpirti i tij është rrënjosur thellë në shpirtin tonë. Dhe ai shpirt sot po të dërgon jehonën e tij të revoltuar kundra gjykimit të helmuar e të padrejtë që po përhap në Shqipëri.

Dhe Faiku vazhdon me stilin e tij të kulluar, po bosh, nga mendimet:

«Ata që duan të zbaviten duke hyrë në një shtëpi të marrësh ku mendimet dhe fjalët s'kanë as lidhje, as kuptim, duhet të këndojnë një vjershë të gjatë të qojtur «parajsa». Një nga gjërat e çudiçme këtu është lajmi se shqiptarët kanë qenë krijuar jo vetëm më parë se Ademi, por edhe më parë se hëna».

Ja vjersha të cilën Faik Beu e quan shtëpi të martësh:

*«Ademi dhe s'kishte lerë,
 Kërthiza s'i ishte prerë,
 Ay ishte ujë e baltë,
 Ne ishim njerëz të naltë.*

*Hëna dhe s'ishte në jetë,
Dheu s'kish bar e fletë
Kur ka lindur shqiptari
Është nga gjithë m'i pari
U vu emër perëndive
Edhe gjithë bagëtive...»*

Përse kjo vjershë i përrngjaka shtëpisë së të marrëve? Naimi nuk bën as histori, as sociologji, as astronomi. Bën poezi. Dhe në poezi shumë gjëra lejohen. Ndjenja shqiptare e theksuar e Naimit shprehet në një mënyrë lirike.

Përse gjermanët dhe japonezët thonë se janë popull i zgjedhur prej Zotit? Mos nuk e dinë vallë ata se një gjë e tillë s'është e vërtetë? U bë kjameti pse tha Naimi se populli shqiptar qenka lindur para se të lindej hëna? Po ta gjykosh kështu poezinë, të gjithë poetët, pa përjashtim, dalin të çmendur.

Apo ndofta një miljon shqiptarë, përvèç Faikut, janë të marrë? E ku ta dish...

Faiku shton: «Po kur quajmë vjershëtor, dhe vjershëtor të madh një bërës tototo e tatatash, ç'fjalë do të mbetet pér një Gjergj Fishtë?»

Faik Bej! Ka vend në Shqipëri edhe pér Patër Gjergjin, edhe pér Naimin. Njeri nuk përjashton tjetrin. Dy poetë (edhe më tepér se dy) mund të jetojnë, dua të them mund të bashkënderohen. Apo jo? Ç'mendim ke zotrote? Pse Patër Gjergji është poet i madh, a do të thotë vallë kjo se Naimi është vargradhës dhe pallavraxhi?

Nuk më duket ky një arsyetim serioz dhe i vlerëtë.

Se përdorte Naimi foljen «ishte» në vend të «ish» dhe «pellazgi» në vend të «pellazgët», a është vallë ky një krim poetik, ose më mirë gjuhësor?

Po apostrofat e famëshme që përdorin sot poetët e veriut, përsë nuk qenkan edhe ato një «gabim»?

Poezia lejon shumë gjëra që janë të ndaluara në prozë.

Zotrote Faik Bej e di më mirë se kushdo; por kur vendos që ta varrosësh (ndonëse i vdekur) një njeri, përdor qdo mjet.

Edhe disa vargje jo nga më të mirat, për t'i tre-guar Faikut se Naimi është poet:

*«Kraharorin e kam çpuar,
E kam bërë vrima-vrima,
Dhe kam qarë e kam rënkuar
Me mijra pshëretima..»*

Poeti dhe fyelli. Poeti e krahason veten me fye-llin që qan në vetmi, në mes të natyrës së egër. Dhe në kryeveprën e tij «Bagëti e Bujqësi»:

*Tek buron ujët e ftohtë, edhe fryn veriu në verë,
Tek mbin lulja me gas shumë dhe me bukuri e me erë,
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtija,
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam mënt e mijë..»*

Duke u përulur përpara eshtrave të Bilbilit të Frashërit, populli shqiptar nuk nderoi vetëm pionerin e lartë të nacionalizmit, por edhe poetin; u nderua sinqerisht ai poet vlerën e të cilit më kot kërkon ta dërmojë Faik Konica. Tashti që jam duke shkruar këto radhë pyes veten:

A i beson vallë seriozisht ato që shkruan Faik Konica? Apo mos ka qejf të shkruajë tamam të kundërtën e asaj që mendon shumica? Se rrojmë në shekullin e paradoksave! «Meqenëse shumica i japid një vlerë letrare Naimit, le t'ja mohoj unë», ka thë-

në me vete Faiku, «se kështu bëhet bujë». Është e vërtetë. Kështu bëhet bujë. Po kështu bastardohe.. penat nga të cilat atdheu pret vepra letrare serioze dhe jo sharje, ironi dhe tallje kundra pionierve me vlerë letrare «të pakontestueshme» por jo të «pakkontestuar.»

«Njeriu kurmplaket rifillon jetën e foshnjërisë», thotë proverbi, dhe frengu shton: «Les extremes se touchent». ¹⁾

Gazeta «Shtypi», 17 gusht 1937

38128

1) Ekstremet takohen.

TRYEZA E LËNDËS

Faqe

Parathënie	5
Fajtori	13
Ironi e shekullit	16
Gjenjeshtra që duhen besuar	18
Fjalë për të zbukuruar muzetë	21
Diplomatët ven' e vinë	23
Palla e Lekës së madh	25
Lajme telegrafike	27
Të dy tiranasit	29
Floriri	31
Shetitje në gjumë	34
Krimi më i madh i historisë	37
Të gjitha gabime	39
Endëra e këndëshmë	42
Intervistë me malsorin	44
Sporti	46
Maska të çjerra	48
Oratori	51
Shosha e arixhiut	53
Statistika	56
Tutje-tëhu	58
Historia e botës më gjashtë fjalë	60
Jallan shahitet	62
Persekutime	64
Dambllaja tu bjerë	66
Millomaj dhe dhaskali filozofojnë	68
Dramë me tre akte	70
Kur rrukulliset dollari	73
Zbritje e rrogave	75
Politikë popullore	77
Dy adhuronijs japonit	79
Poker më katersh	80
Gjashtëdhjetë e gjashtë	82

Naltmadhëria e tij Financa	84
Shoqëri anonyme	86
Dy botë	88
Varrim në heshtje	90
Këndezi, pula apo vezë	92
Vitin e parë të jetës	94
Gjysmë ore jo shqiptar	96
Romantika e urisë	99
Musa Juka	101
Kur dhemb dhëmballa	103
Dhembi i urtësisë	105
Balta qiellore	107
Autobiografia e një të marri	109
Vakëfi	112
Varrimi i poëtit	114
Bardhi protagonist	117
Vdekja e profesorit	121
Njëqind flamurë, pa një	124
Faiku kundra Naimit	129

Redaktor: Halil Qəndro
Korektor letrar: Neka Turkeshi
Kopertina: Ibrahim Çezma
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 4000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë 1966